

**Union Bank Sh.a.**

**Informacion Financiar Periodik**

**31 Mars 2026**

## TABELA PËRMBLEDHËSE

1. Aktiviteti kryesor, Organizimi, Drejtimi & Kontrolli dhe Kodi i Etikës së Bankës .....	1
2. Bilanci kontabël, Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve, Tregues të rentabilitetit .....	18
3. Struktura e Kapitalit Rregullator .....	23
4. Mjaftueshmëria e Kapitalit .....	24
5. Informacion i Përgjithshëm për Ekspozimin ndaj Rreziqeve dhe Administrimin e Tyre ....	28
6. Borxhi i Varur .....	32
7. Rreziku i Kredisë .....	33
8. Rreziku i Tregut (FX +IRR) .....	36
9. Rreziku i Likuiditetit .....	37
10. Rreziku Operacional.....	38
11. Rreziqet mjedisore, sociale dhe të qeverisjes (“ESG”) .....	39
12. Politika e Shpërblimit.....	39
13. Politikat kontabël të Bankës .....	41

## 1. Aktiviteti kryesor, Organizimi, Drejtimi & Kontrolli dhe Kodi i Etikës së Bankës

### 1.1. Informacioni i përgjithshëm mbi bankën

Union Bank Sh.a. (“Banka”) është një institucion financiar i regjistruar si bankë tregtare më 9 Janar 2006 bazuar në Vendimin nr. 101, datë 28 Dhjetor 2005 të Këshillit Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë. Banka vepron sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Autoriteti mbikëqyrës dhe rregullator i saj është Banka e Shqipërisë, por ajo vepron edhe në bazë të rregullave të nxjerra nga autoritete të tjera përkatëse. Ajo ofron shërbime bankare për individë dhe kompani në Republikën e Shqipërisë. Banka është regjistruar si person juridik me numër regjistrimi 33563 datë 26 Maj 2005, datë në të cilën filloi aktivitetin e saj tregtar.

Ajo zotëron 81% (2024: 81%) të aksioneve të Landeslease sha (“LL”) që prej Dhjetor 2014. Landeslease është një shoqëri shqiptare e regjistruar si një shoqëri aksionare, i cili ushtron aktivitetin e qirasë financiare dhe filloi të operonte në 5 Prill 2005 (Seksioni 1.4).

Banka gjithashtu zotëron 100% (2024: 0%) të aksioneve të Albanian Financial Institution sh.p.k. (“AFI”), pas përfundimit të procesit të blerjes dhe marrjes së miratimit rregullator në tetor 2025. Filiali është një shoqëri shqiptare, institucion financiar jo-bankar, i licencuar nga Banka e Shqipërisë, që ofron kryesisht leasing për automjete dhe pajisje. Në datën e blerjes, totali i aktiveve të AFI përfaqëson më pak se 1% të aktiveve totale të Bankës. (Seksioni 1.4).

AFI dhe LL janë Filialet e Bankës.

Selia e Bankës është në Bulevardin Zogu I, Tiranë

### 1.2. Kapitali aksionar i regjistruar në QKB

Kapitali i nënshkruar i Bankës konsiston në 2,097,143 aksione (31 Dhjetor 2025: 2,097,143 aksione) me vlerë nominale 14.77 Euro (31 Dhjetor 2025: 14.77 Euro) secili dhe është detajuar si më poshtë.

	31 Mars 2026	31 Dhjetor 2025
Unioni Financiar Tiranë Sh.p.k (“UFT”)	96.46%	96.46%
Edmond Leka	1.77%	1.77%
Niko Leka	1.77%	1.77%

Më poshtë paraqiten lëvizjet në kapitalin e paguar në vitet 2026 dhe 2025.

	31 Mars 2026		31 Dhjetor 2025	
	Nr. i aksioneve	Vlera e aksioneve	Nr. i aksioneve	Vlera e aksioneve
Gjendja në fillim të vitit	2,097,143	3,883,812	2,097,143	3,883,812
<b>Kapitali i paguar</b>	<b>2,097,143</b>	<b>3,883,812</b>	<b>2,097,143</b>	<b>3,883,812</b>


Kapitali i paguar përbëhet nga aksione të zakonshme dhe nuk ka asnjë kufizim mbi to apo dallim ndërmjet tyre.

### 1.3. Informacion për strukturën e organizimit, të administrimit dhe funksionimit të Bankës

Banka ushtron aktivitetin e saj nëpërmjet rrjetit të saj të degëve me një shtrirje të qëndrueshme në qytete të ndryshme të vendit, të cilat në fund të Mars 2026 përfshinin 33 degë, 73 ATM dhe shërbimet e *Internet Banking*, *Mobile Banking* dhe *E-Commerce*.

Më 31 Mars 2026 Banka kishte 567 punonjës (31 Dhjetor 2025: 564).

Më poshtë paraqitet Struktura Organizative e Bankës:



### 1.3.1 Struktura e organeve drejtuese

#### a. Këshilli Drejtues

Edmond Leka	Kryetar
Niko Leka	Zv.Kryetar
Varuzhan Piranjani	Anëtar
Henry Russell	Anëtar
Gazmend Kadriu	Anëtar
Teuta Baleta	Anëtar
Flutura Veipi	Anëtar edhe CEO
Kreshnik Dibra	Anëtar
Mërgim Cahani	Anëtar

#### b. Komiteti i Kontrollit

Teuta Baleta	Kryetar
Sonila Bıçaku	Anëtar
Kreshnik Dibra	Anëtar

#### c. Komiteti i Strategjisë

Edmond Leka	Kryetar
Flutura Veipi	Anëtar
Henry Russell	Anëtar
Niko Leka	Anëtar
Gazmend Kadriu	Anëtar

#### e. Drejtoria Ekzekutive

Flutura Veipi	Kryetar dhe Përgjegjës për Operacionet e Biznesit
Suela Bokshi	Anëtar dhe Përgjegjës për Operacionet Back office
Arten Zikaj	Anëtar dhe Përgjegjës për Menaxhimin e Rrezikut dhe Financën
Alban Burazeri	Anëtar dhe Përgjegjës për Inovacionin, Biznesin dhe Operacionet e IT-së, Aktivitetet që lidhen me Transformimin

#### f. Drejtorë Divizionesh

Arten Zikaj	Drejtor i Divizionit të Financës
Enkeleda Hasho	Drejtor i Divizionit të Klientëve Biznes
Gent Drita	Drejtor i Divizionit të Kredisë
Irena Rushaj	Drejtor i Divizionit të Teknologjisë së Informacionit
Suela Bokshi	Drejtor i Divizionit të Operacioneve
Alban Burazeri	Drejtor i Transformimit dhe Inovacionit
Armald Imeraj	Drejtor i Divizionit të Ofrimit të Proceseve të Biznesit dhe Inovacionit

#### g. Komiteti i Shpërblimit dhe Burimeve Njerëzore

Varuzhan Piranjani	Kryetar
Teuta Baleta	Anëtar
Elton Çollaku	Anëtar

#### d. Komiteti i Rrezikut

Gazmend Kadriu	Kryetar
Elda Demneri	Anëtar
Artiola Agalliu	Anëtar

**Këshilli Drejtues i Bankës** mbledhet rregullisht duke zhvilluar jo më pak se 5 (pesë) mbledhje kryesore të rregullta në vit dhe disa mbledhje të ndërmjetme, të cilat organizohen, sipas nevojës, në periudhat ndërmjet mbledhjeve të planifikuara. Këto mbledhje zhvillohen ndër të tjera, për të miratuar strategjinë e përgjithshme dhe drejtimin e Bankës, për të marrë vendime të rëndësishme organizative dhe lidhur me kreditimin, buxhetimin, si dhe për të monitoruar ecurinë së veprimtarisë së Bankës, me fokus të veçantë në performancën dhe menaxhimin e rreziqeve. Këshilli Drejtues shqyrton dhe miraton çdo vit të gjitha politikat e Bankës si dhe çdo dokument tjetër të kërkuar nga kuadri rregullator apo rregulloret e brendshme të Bankës. Vendimet e Këshillit Drejtues janë të vlefshme nëse shumica e anëtarëve të pranishëm pjesëmarrës në mbledhje voton në favor ose votim me 2/3 për vendimmarrje specifike me rëndësi të veçantë. Në rastet kur ekziston konflikt interesi, vendimi merret pa pjesëmarrjen e anëtarit ose anëtarëve përkatës në diskutim dhe votim.

Anëtarët e Këshillit Drejtues përzgjidhen në përputhje me kriteret ligjore dhe ato të veçanta të përcaktuara nga banka, përmes një procesi të strukturuar vlerësimi të ekspertizës së kandidatëve dhe vlerësimit të diversitetit.

Çdo anëtar, pas propozimit nga ana e Bankës, miratohet gjithashtu nga Banka së Shqipërisë. Në mënyrë periodike, Këshilli Drejtues kryen rregullisht monitorimin e treguesve të performancës së strukturave drejtuese, si dhe vlerësimin e përshtatshmërisë së drejtuesve.

Për të përmbushur përgjegjësitë e tij në mënyrë sa më efektive, Këshilli Drejtues themelon komitete të përhershme dhe të përkohshme. Aktualisht veprojnë katër komitete të përhershme si në vijim:

- Komiteti i Kontrollit

- Komiteti i Shpërblimit dhe Burimeve Njerëzore
- Komiteti i Strategjisë
- Komiteti i Rrezikut

Komitetet përbëhen nga anëtarë të Këshillit Drejtues të Bankës, si dhe sipas rastit, ekspertë të jashtëm, në përputhje me natyrën e komitetit dhe kërkesat rregullatore për përbërjen e tyre.

**Komiteti i Kontrollit** ka si funksion kryesor që të këshillojë Këshillin Drejtues në plotësimin e përgjegjësive në procesin e raportimit financiar dhe monitorimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret.

Detyrat kryesore të Komitetit të Kontrollit përmblihen në mbikëqyrjen e:

- Integritetit të raporteve financiare të Bankës;
- Përputhshmërinë e Bankës me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Procesit të përzgjedhjes dhe të performancës së audituesve të jashtëm;
- Performancës së Departamentit të Auditit të Brendshëm;

Komiteti i Kontrollit të Bankës ka në përbërje kryetarin, dy anëtarë, nga të cilët njëri ekspert i jashtëm. Mund të angazhohë dhe një ose më shumë “anëtarë shok”, në funksion të plotësimin të profilit profesional dhe planit të vijueshmërisë.

**Komiteti i Shpërblimit dhe Burimeve Njerëzore** (“KSHBNJ”) ka si funksion kryesor që të këshillojë dhe mbështesë Këshillin Drejtues në kryerjen e përgjegjësive të tij lidhur me çështjet që lidhen me Burimet Njerëzore (“BNJ”) të tilla si:

- Vendosjen dhe rishikimin e politikave të shpërblimeve në fusha si kompensimet dhe përfitimet e punonjësve;
- Politikat dhe Procedurat që lidhen me punësimin dhe largimin nga puna të punonjësve të niveleve të larta në Bankë;
- Shqyrtimin dhe rishikimin e zhvillimeve të rëndësishme në çështje si: Kodi i Sjelljes dhe Struktura Organizative; Politikat që asistojnë afrimin, mbajtjen, planet e zëvendësimit dhe zhvillimin e punonjësve të Bankës.

Komiteti i Shpërblimit dhe Burimeve Njerëzore ka në përbërje kryetarin dhe dy anëtarë.

**Komiteti Strategjik** ka si qëllim të këshillojë Këshillin Drejtues në lidhje me çështje ose aktivitete që bien në fushën kryesore të vendimeve strategjike. Të tilla mund të jenë:

- Rishikimi i strategjisë së Bankës;
- Ristrukturim madhor i brendshëm i Bankës;
- Mundësi blerjeje (acquisition);
- Planifikim i hapjes së një filiali, etj;

Komiteti Strategjik ka në përbërje 5 (pesë) anëtarë duke përfshirë Kryetarin dhe Zëvendëskryetarin e KD-së si dhe Drejtorin e Përgjithshëm Ekzekutiv.

**Komiteti i Rrezikut** ka si qëllim kryesor të shqyrtojë dhe diskutojë dokumentet që lidhen me menaxhimin e rrezikut, të përgatitura nga Drejtoria Ekzekutive. Kjo tregon për rëndësinë që i jepet trajtimit të çështjeve të rrezikut, duke mundësuar një analizë më të thelluar dhe më të përqendruar sesa ajo që do të ishte e mundur në mbledhjet e zakonshme të Këshillit Drejtues. Puna e këtij komiteti zhvillohet në tri nivele:

- Së pari, ai fokusohet në çështjet që kërkojnë drejtpërdrejt nga Këshilli Drejtues dhe që janë përcaktuar si prioritet.
- Së dyti, komiteti mund të merret edhe me tema të tjera të lidhura me rrezikun të propozuara nga Drejtoria Ekzekutive, nëse kjo pranohet nga vetë Komiteti i Rrezikut.
- Së fundi, adreson edhe çështje të tjera të lidhura me rrezikun që dalin gjatë punës së tij.

Komiteti i Rrezikut ka në përbërje kryetarin dhe 3 (tre) anëtarë.

**Drejtoria Ekzekutive (DE)**, është përgjegjëse për administrimin e aktivitetit të Bankës në tërësi, kontrollin dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme të zbatueshmërisë së kuadrit rregullativ të Bankës, ndër të cilat përfshihet standardizimi i rregulloreve dhe procedurave, administrimi i çështjeve të administrimit të rrezikut dhe të kontrollit të brendshëm në përputhje me kuadrin e brendshëm rregullativ, rregulloret e Bankës së Shqipërisë dhe praktikat më të mira. DE organizon veprimtarinë e përditshme të Bankës, përcakton përgjegjësitë e funksioneve të Bankës si dhe të linjave të kontrollit. Po ashtu, ky funksion organizon proceset që sigurojnë identifikimin, vlerësimin e saktë të rreziqeve si dhe masat e nevojshme për administrimin e rreziqeve të Bankës.

DE përmbledh dhe propozon për miratim në Këshillin Drejtues planin, buxhetet dhe projeksionet e biznesit, të përgatitura nga njësitë përgjegjëse të Bankës, të cilat më tej do të përdoren, ndër të tjera, edhe për qëllime të planifikimit të mjaftueshmërisë së kapitalit dhe të likuiditetit. Gjithashtu, DE është përgjegjëse për identifikimin e rreziqeve materiale dhe i komunikon rezultatet Këshillit Drejtues për aprovim, në kuadër të politikave specifike dhe Kuadrin e Oreksit të Rrezikut. Për një monitorim më efikas, analiza më të plota, dhe strukturë vendimmarrëse më të gjerë me qëllim administrimin sa më efektiv të proceseve/aktivitetit dhe administrimin e rrezikut, DE ka krijuar komitete të veçanta që mbulojnë rreziqe individuale. Komitetet e ngritura në Bankë janë:

a. Komiteti i Administrimit të Aktiv – Pasiv (KAAP)\*

Flutura Veipi	Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Kryetar i Drejtorisë Ekzekutive
Arten Zikaj	Drejtor i Divizionit të Financës dhe Anëtar i Drejtorisë Ekzekutive (Kryetar)
Illirjan Ligaçaj	Drejtor i Departamentit të Thesarit
Gresa Panajoti	Drejtor i Departamentit të Menaxhimit të Rrezikut

\*) për t'u plotësuar me 5 anëtarë

b. Komiteti i Rrezikut Operacional dhe Rreziqet e Tjera

Arten Zikaj	Drejtor i Divizionit të Financës dhe Anëtar i Drejtorisë Ekzekutive (Kryetar)
Suela Bokshi	Drejtor i Divizionit të Operacioneve dhe Anëtar i Drejtorisë Ekzekutive
Dritan Nini	Drejtor i Departamentit të Operacioneve
Gresa Panajoti	Drejtor i Departamentit të Menaxhimit të Rrezikut
Admir Xhani	Drejtues i Njesisë së Rreziqeve të Tregut dhe Rrezikut Operacional

c. Komiteti i Menaxhimit të Rrezikut të Kredisë (KARK)

Flutura Veipi	Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Kryetar i Drejtorisë Ekzekutive
Gent Drita	Drejtor i Divizionit të Kredisë (Kryetar)
Arten Zikaj	Drejtor i Divizionit të Financës dhe Anëtar i Drejtorisë Ekzekutive
Gresa Panajoti	Drejtor i Departamentit të Menaxhimit të Rrezikut
Lorenc Sulanjaku	Drejtor i Departamentit për Rrezikun e Kredive të Biznesit
Borana Bakiasi	Drejtor i Departamentit të Rrezikut të Kredive për Individë
Inesa Zhezha	Shef i Njesisë së Kontrollit të Kredive

d. Komiteti i Menaxhimit të Rrjetit

Flutura Veipi	Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Kryetar i Drejtorisë Ekzekutive (Kryetar)
Suela Bokshi	Drejtor i Divizionit të Operacioneve dhe Anëtar i Drejtorisë Ekzekutive
Enkelelda Hasho	Drejtor i Divizionit të Klientëve Biznes
Elma Lako	Drejtor i Qendrës së Shitjeve Retail dhe Rrjetit të Shpërndarjes

e. Komiteti i Teknologjisë së Informacionit

Flutura Veipi	Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Kryetar i Drejtorisë Ekzekutive
Alban Burazeri	Drejtor i Transformimit dhe Anëtar i Drejtorisë Ekzekutive (Kryetar)
Irena Rushaj	Drejtor i Divizionit IT
Ermal Galo	Menaxher i Sigurisë së Informacionit

f. Komiteti i Administrimit të Kolateraleve në Pronësi të Bankës

Suela Bokshi	Drejtor i Divizionit të Operacioneve dhe Anëtar i Drejtorisë Ekzekutive (Kryetar)
Arten Zikaj	Drejtor i Divizionit të Financës dhe Anëtar i Drejtorisë Ekzekutive
Gent Drita	Drejtor i Divizionit të Kredisë
Andrit Brozha	Drejtues i Njesisë së Vlerësimit të Pasurive

g. Komiteti i Përputhshmërisë

Flutura Veipi	Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Kryetar i Drejtorisë Ekzekutive (Kryetar)
Arten Zikaj	Drejtor i Divizionit të Financës dhe Anëtar i Drejtorisë Ekzekutive
Artion Pashollari	Drejtor i Departamentit të Këshillimit Ligjor
Gresa Panajoti	Drejtor i Departamentit të Menaxhimit të Rrezikut

\*) Drejtues i Njesisë së Përputhshmërisë

\*) Pozicion vakant

h. Komiteti i Menaxhimit të Kapitalit dhe Performancës

Flutura Veipi	Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Kryetar i Drejtorisë Ekzekutive (Kryetar)
Arten Zikaj	Drejtor i Divizionit të Financës dhe Anëtar i Drejtorisë Ekzekutive
Gresa Panajoti	Drejtor i Departamentit të Menaxhimit të Rrezikut

**Banka Union**

Raportet Financiare Periodike, Mars 2026

(shifrat në Mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

i. Komiteti i Kredisë

Flutura Veipi	Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Kryetar i Drejtorisë Ekzekutive (Kryetar)
Enkeleda Hasho	Drejtor i Divizionit të Klientëve Biznes
Gent Drita	Drejtor i Divizionit të Kredisë

k. Komiteti Drejtues i Projekteve

Suela Bokshi	Drejtor i Divizionit të Operacioneve dhe Anëtar i Drejtorisë Ekzekutive (Kryetar)
Alban Burazeri	Drejtor i Transformimit dhe Anëtar i Drejtorisë Ekzekutive
Dallandyshe Çela	Drejtor i Departamentit të Organizimit
Irena Rushaj	Drejtor i Divizionit IT

m. Komiteti i Rikuperimit dhe Menaxhimit të Vonesave

Flutura Veipi	Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Kryetar i Drejtorisë Ekzekutive (Kryetar)
Gent Drita	Drejtor i Divizionit të Kredisë
Roland Mitllari	Drejtor i Departamentit të Menaxhimit të Portofolit të Kredive

o. Komiteti i Sigurisë në Punë

Alban Muharremi	Drejtor i Departamentit të Sigurisë
Marika Martiri	Drejtor i Departamentit të Administratës
Gentiana Josifi	Drejtor i Burimeve Njerëzore dhe Kulturës Organizative
Dorina Stringa	Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Ligjore
Elma Lako	Drejtor i Qendrës së Shitjes Retail dhe Rrjetit të Shpërndarjes
Gresa Panajoti	Drejtor i Departamentit të Menaxhimit të Rrezikut

Anëtarë me zgjedhje nga stafi

Myrvete Asqeri (Kryetar)  
Ilija Miti  
Enkeleda Hasho  
Ardesian Binjakaj  
Eltin Qerazi  
Leonora Shosha

j. Komiteti i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore

Flutura Veipi	Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Kryetar i Drejtorisë Ekzekutive (Kryetar)
Suela Bokshi	Drejtor i Divizionit të Operacioneve dhe Anëtar i Drejtorisë Ekzekutive
Gentiana Josifi	Drejtor i Burimeve Njerëzore dhe Kulturës Organizative

l. Komiteti i Menaxhimit të Produktit

Flutura Veipi	Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Kryetar i Drejtorisë Ekzekutive (Kryetar)
Suela Bokshi	Drejtor i Divizionit të Operacioneve dhe Anëtar i Drejtorisë Ekzekutive
Enkeleda Hasho	Drejtor i Divizionit të Klientëve Biznes
Illirjan Deralla	Drejtor i Departamentit të Zhvillimit të Produkteve Retail
Gresa Panajoti	Drejtor i Departamentit të Menaxhimit të Rrezikut
Alma Derraj	Drejtor i ODA, Vatër për zgjidhje të kërkesave të klientëve

n. Komiteti i Prokurimeve

Flutura Veipi	Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Kryetar i Drejtorisë Ekzekutive (Kryetar)
Suela Bokshi	Drejtor i Divizionit të Operacioneve dhe Anëtar i Drejtorisë Ekzekutive
Marika Martiri	Drejtor i Departamentit të Administratës
Ilir Apostol	Drejtues i Njesisë së Prokurimeve

**a) Komiteti i Administrimit të Aktiv-Pasivit ("KAAP")** (shih. Faqe 30) është organi përgjegjës për menaxhimin e balancës ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve të Bankës, me qëllim optimizimin e performancës financiare duke ruajtur stabilitetin financiar dhe qëndrueshmërinë afatgjatë. Ai merr në shqyrtim situatën dhe kushtet ekonomike kombëtare dhe ndërkombëtare, zhvillimet rregullatore, tendencat dhe luhatshmërinë e tregjeve, lëvizjet e normës së interesit, kurseve të këmbimit, etj. Në analizat dhe mbledhjet e komitetit shqyrtohet struktura e aktiv-pasiveve, portofoli i investimeve, pozicioni valutor, treguesit aktual dhe në perspektivë të likuiditetit lidhur me mospërputhjen e maturiteteve në bilanc në kuadër të monitorimit dhe menaxhimit të rreziqeve të tregut të lidhura me to. Po ashtu, në mbledhjet e KAAP diskutohet mbi performancën e përgjithshme të Bankës, nivelin e mjaftueshmërisë së kapitalit dhe ai i likuiditetit, rendimentet e aktiv/pasivit dhe *spread*-et e normave të interesit, kundërpartitë e mundshme në Tregun e Parasë si dhe limitet për zyrat e këmbimit. Komiteti merr vendime sa i takon normave të interesit të depozitave apo produkteve të lidhura me to, investimeve në letra me vlerë të huaja, huamarrjen, niveleve të *cash-it*, etj. Po ashtu, kryhet koordinimi i çmimit të produktit në mënyrë që *spread*-et e synuara të arrihen dhe mbahen në linjë me koston e financimit dhe kostot e tjera të Bankës, në mënyrë që të arrihet përfitueshmëria e synuar mbi aktive/kapitalin e vet (ROA, ROE) si dhe të mbrohet Banka nga rreziku i normave të interesit. Ky komitet propozon me periodicitet vjetor ndryshimet e politikave nën administrimin e komitetit, dhe aprovon ndryshimin e procedurave të aktiv/pasivit mbi baza të vazhdueshme kur ndryshimi i kushteve e kërkon një veprim të tillë. Politikat shkojnë për aprovim në Këshillin Drejtues si rregull një herë në vit. Në këtë komitet bëhet edhe shpjegimi i ndonjë përjashtimi të njohur nga kjo politikë, si dhe një plan veprimi dhe afati kohor për ta sjellë Bankën në përputhje me kufijtë e politikës. Me zgjerimin e kuadrit rregullator, në KAAP diskutohen edhe elementet relevant të *ICAAP* si dhe rishikohet dhe aprovohet drafti i *ILAAP* (proceset e vlerësimit të brendshëm të kapitalit dhe likuiditetit) para se të shkojnë për aprovim final në Këshillin Drejtues.

**b) Komiteti i Rrezikut Operacional dhe Rreziqet e Tjera ("KRORT")** (shih. Faqe 31) është përgjegjës për analizën sistematike të profilit të rrezikut operacional në nivel Banke, në përputhje me strategjinë dhe apetin për rrezik të miratuar nga Këshilli Drejtues; rishikimin, vlerësimin dhe trajtimin e ngjarjeve të rrezikut operacional që janë materializuar, përfshirë ngjarjet me ndikim të konsiderueshëm financiar ose reputacional; analizën e humbjeve operationale, identifikimin proaktiv të proceseve me rrezik të shtuar operacional, përmes analizës së indikatorëve kyç të rrezikut (KRI) dhe vlerësimit të vetë-rrezikut nga njësitë përkatëse (RCSA); si dhe rekomandimin dhe ndjekjen e masave korrigjuese, për të adresuar mangësitë e konstatuara dhe për të reduktuar ekspozimin ndaj rrezikut operacional. Gjithashtu në këtë komitet analizohen ngjarjet e "mashtimit" që mund të ndodhin në Bankë, si dhe përcaktohet skuadra që do të hetojë këtë ngjarje të tilla, duke mbështetur standardet për etikë, kontroll të brendshëm dhe integritet. Komiteti gjithashtu propozon dhe zbaton testimin e planit të vazhdimësisë së biznesit dhe përmbledh rezultatet duke dhënë në fund edhe rekomandimet.

**c) Komiteti i Menaxhimit të Rrezikut të Kredisë ("KMRK")** (shih. Faqe 31) është kryesisht përgjegjës për shqyrtimin dhe vendimmarrjen mbi ekspozimet kreditore, duke siguruar që procesi i huadhënies të jetë në përputhje me tolerancën ndaj rrezikut, politikën e kredisë dhe kërkesat rregullatore. Ky komitet luan rol kyç në zbatimin e strategjisë së menaxhimit të rrezikut të kredisë sa i përket portofolit kreditor. Komiteti siguron që procedurat e kredisë të jenë në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi si dhe me politikën e kredisë, e cila aprovohet dhe rishikohet nga Këshilli Drejtues si rregull një herë në vit. Ai shqyrton përputhshmërinë me limitet dhe monitoron treguesit dhe limitet e paralajmërimit të hershëm të vendosur nga Banka në fushën e rrezikut të kredisë.

Në këtë komitet shqyrtohen parashikimet makroekonomike dhe zhvillimet financiare në vend, të cilat ndikojnë në rrezikun e kredisë si dhe rishikohen periodikisht rezultatet e stress test-eve për cilësinë e portofolit të kredisë së Bankës. KMRK ka rol të rëndësishëm në implementimin e politikave të provigjionimit, përfshirë kategorizimin dhe kriteret bazë të provigjionimit të tyre. Rikuperimi dhe fshirja e kredive (përpara miratimit përfundimtar nga Këshilli Drejtues) janë një pjesë e rëndësishme e fushës së punës së këtij komiteti. Komiteti shqyrton në baza vjetore kërkesat e brendshme për kapital të lidhura me rrezikun e kredisë, në kuadër të procesit të PVBMK.

**d) Komiteti i Menaxhimit të Rrjetit** është një organ konsultativ i menaxhimit, i cili ka për qëllim të trajtojë çështje të rëndësishme lidhur me veprimtarinë e degëve si dhe të asistojë DE-në në marrjen e vendimeve që kanë të bëjnë me fusha të ndryshme që prekin rrjetin e degëve. Ky komitet mbikëqyr strategjinë e menaxhimit të rrjetit në të gjitha kanalet e Bankës si degët, bankingu on-line, palët e treta, ATM-të, etj. Funkzioni kryesor i këtij komiteti është ndjekja dhe monitorimi i rezultateve të degëve, performancës së tyre, bazuar në indikatorët kryesorë të matjes së performancës, si targeti vjetor dhe objektivat e vendosura në fillim të vitit. Përveç indikatorëve sasiorë, Komiteti i Menaxhimit të Rrjetit analizon dhe vlerëson aktivitetin e rrjetit në tërësi përfshirë vendndodhjen e degëve, transferimet e mundshme apo dhe hapje/mbyllje degësh, çështje të rëndësishme të lidhura me punonjësit kryesisht në nivelet menaxheriale, strukturën e degëve, etj.

**e) Komiteti për Teknologjinë e Informacionit (“KTI”)** ka si funksion kryesor të sigurojë që nevojat dhe objektivat e Bankës në lidhje me teknologjinë e informacionit dhe përfitimet e marra prej saj të përmbushen plotësisht. Gjithashtu ky komitet menaxhon dhe vendos prioritetet sa lidhur me projektet dhe kërkesat që vijnë në kuadër të automatizimit të proceseve apo nevojave strategjike.

**f) Komiteti i Administrimit të Kolateraleve në Pronësi të Bankës** është organi që administron procesin e shitjes, qiradhënies apo lënies në përdorim së kolateraleve të kaluar në pronësi të Bankës si rezultat i procesit të ekzekutimit ligjor të kredive. Komiteti propozon momentin e nxjerrjes në shitje të një aseti duke përcaktuar çmimin fillestar të shitjes si dhe raundet e marketimit. Ky komitet është përgjegjës për përcaktimin e një strategjie të përgjithshme që duhet ndjekur për përcaktimin e destinacionit afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës si edhe marketimin dhe shitjen e asetit. Gjithashtu në këtë komitet merret vendimi për dhënie me qira ose në përdorim të pronës si dhe ndiqet marketimi i pronave sipas kanaleve standarde të tregut. Komiteti kryen kategorizimin, vlerësimin dhe monitorimin e vlerës së tregut të pronave si dhe llogaritjen e provigjoneve sipas standardeve të raportimit.

**g) Komiteti i Përputhshmërisë** ka detyrën për të zhvilluar dhe zbatuar politikën e përputhshmërisë duke siguruar respektimin e ligjeve, rregulloreve dhe standardeve. Në këtë komitet diskutohen implikimet e zhvillimeve rregullative për Bankën duke vënë prioritetet e duhura për menaxhimin e rrezikut të përputhshmërisë e duke propozuar masat për zbutjen e rreziqeve të tilla. Komiteti analizon dhe diskuton për implikimet e ligjeve dhe rregulloreve në aktivitetin e Bankës.

**h) Komiteti i Menaxhimit të Kapitalit dhe Performancës (“KMKP”)** (shih. Faqe 32) ka si funksion kryesor të sigurojë që planifikimi, menaxhimi dhe monitorimi i kapitalit të Bankës, si dhe treguesit e lidhur me të, të jenë në përputhje me objektivat strategjikë dhe kërkesat rregullatore. Ky komitet fokusohet në tre komponentë të rëndësishëm sic janë menaxhimi i kapitalit, vlerësimi i planit të rimëkëmbjes dhe vlerësimi i performancës financiare të Bankës lidhur me kapitalin. Ai merr në konsideratë dhe monitoron kërkesat rregullatore për Shtesën e Kombinuar Makroprudenciale të Kapitalit (SHKOMAK), të levës financiare si dhe kërkesat e ligjit për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme. Komiteti, së bashku me inputin e KMAP, KMRK apo KRORT aprovon rezultatet e Procesit të Vlerësimit të Brendshëm të Mjaftueshmërisë së Kapitalit (PVBMK) para se të paraqiten në KD për aprovim përfundimtar, dhe monitoron në mënyrë periodike treguesit e paralajmërimit të hershëm të përcaktuar në dokumentin e PVBMK. Komiteti shqyrton edhe rezultatin e buxhetit sa i takon treguesit të RMK, kundrejt kërkesave të PVBMK dhe pritshmërive të SHKOMAK duke përfshirë skenarët e rritjes, përbërjen e aktiveve, provigjionet dhe rezultatin e pritjeve financiar të Bankës. Komiteti shqyrton dhe analizon realizimin e buxhetit dhe çdo devijim prej tij për sa i përket ndikimit që mund të ketë në kapitalin e Bankës. KMKP është gjithashtu përgjegjës për shqyrtimin dhe analizimin e detajuar të raportit të Planit të Rimëkëmbjes dhe për paraqitjen e tij për miratim përfundimtar pranë KD.

**i) Komiteti i Kredisë (KKr)** (shih. Faqe 31) ka përgjegjësinë e vendimmarrjes, detajimit dhe implementimit të procedurave mbi bazë të politikës së aprovuar nga Këshilli Drejtues në fushën e kredidhënies. Ai siguron që procesi i miratimit të kredive të ndjekë procedurat / politikat e Bankës në përputhje me kuadrin ligjor rregullativ; krijon një sistem të përshtatshëm për raportimin te Këshilli Drejtues lidhur me zbatimin e politikave dhe limiteve kreditore të vendosura. Anëtarët e Komitetit të Kredisë marrin vendime individuale për kreditë e biznesit dhe të individëve bazuar në raportet e vlerësimit të rrezikut të përgatitur nga Departamentet e Rrezikut nën Divizionin e Kredisë.

**j) Komiteti i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore** (“MBNJ”) është strukturë kolektive e përbërë nga anëtarë të DE, Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe departamenteve të tjera të përfshira në vendimmarrjet, lidhur me çështjet e menaxhimit të burimeve njerëzore në përputhje me: Politikat dhe procedurat e Burimeve Njerëzore, Kodie e Etikës, strukturën organizative, politikat e shpërblimit të punonjësve përfshirë pagat, bonuset dhe përfitimet, si dhe politikat për tërheqjen, mbajtjen dhe zhvillimin e punonjësve të Bankës, etj. Ky komiteti trajton çështjet për të gjithë punonjësit, përjashtuar anëtarët e DE dhe disa pozicione kyçe, përgjegjësia për trajtimin e të cilave është e Komitetit të Shpërblimit dhe Burimeve Njerëzore, strukturë e Këshillit Drejtues të Bankës.

**k) Komiteti i Sigurisë në Punë** është komitet i krijuar me pjesëmarrjen edhe të personelit të Bankës. Ai siguron trajtimin dhe monitorimin e elementëve të sigurisë në punë, duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

**l) Komiteti i Menaxhimit të Produkteve** është një strukturë që shërben për të vlerësuar propozimet për produkte të reja ose propozime për ndryshime që lidhen me karakteristikat e produkteve ekzistuese. Objektivi i këtij komiteti është të lehtësojë veprimtarinë e Bankës nëpërmjet studimit të propozimeve të ndryshme që i paraqiten nga Divizionet e Klientëve Biznes dhe Retail apo nga njësi të tjera të Bankës. Detyrat kryesore të komitetit janë: miratimi i propozimeve për produkte të reja, ose modifikimi i produkteve ekzistuese duke përfshirë vlerësimet e rrezikut; sigurimi që këto ndryshime të përputhen me strategjitë e biznesit, të ofrojnë kthim të përshtatshëm në raport me profilin e rrezikut të produktit dhe të jenë të favorshme për tregun e synuar të klientëve; si dhe monitorimi i performancës së produktit, duke përfshirë përfitimin dhe pozicionin konkurrues.

**m) Komiteti i Rikuperimit dhe Menaxhimit të Vonesave** është struktura përgjegjëse për monitorimin dhe orientimin strategjik të procesit të ndjekjes së kredive me probleme dhe atyre në vonesë, me synim rikuperimin sa më efikas të ekspozimeve të rrezikuara dhe minimizimin e humbjeve për Bankën. Ky komitet shqyrton performancën e portofolit me vonesa dhe portofolit të kredive në ndjekje, identifikon tendencat e rrezikut dhe merr vendime mbi trajtimin e rasteve të veçanta, përfshirë miratimin e planeve të ristrukturimit, negociimin e marrëveshjeve të rikuperimit apo referimin e rasteve për ndjekje ligjore. Gjithashtu, Komiteti ndjek zbatimin e strategjive për rikuperimin e huave, vlerëson efikasitetin e strukturave të dedikuara për këtë funksion dhe propozon masa për përmirësimin e proceseve, duke vepruar në përputhje me kuadrin rregullator dhe politikën e menaxhimit të kredive me probleme të Bankës.

**n) Komiteti i Prokurimeve** është përgjegjës për mbikëqyrjen dhe miratimin e proceseve të prokurimit në përputhje me politikat e brendshme të Bankës dhe parimet e transparencës, konkurrencës dhe efijencës. Ky komitet shqyrton dhe miraton kërkesat për prokurime që kalojnë pragjet e miratuara, duke vlerësuar ofertat e paraqitura nga furnitorët në aspektin teknik dhe financiar, përfshirë krahasimin me buxhetin, me qëllim përzgjedhjen e alternativës më të përshtatshme për Bankën. Gjithashtu, Komiteti ka një rol aktiv në sigurimin e integritetit të procesit të prokurimit, duke monitoruar përputhshmërinë me kuadrin rregullator dhe procedurat e brendshme, si dhe duke identifikuar nevoja për përmirësim në mënyrë që procesi të jetë sa më efektiv dhe i besueshëm.

**o) Komiteti Drejtues i Projekteve** ka përgjegjësi për përcaktimin dhe drejtimin e projekteve më të rëndësishme të Bankës. Ai ka një rol aktiv në ndjekjen e realizimit të tyre.

### **1.3.2 Informacion për kualifikimet dhe përvojën e anëtarëve të organeve drejtuese**

#### **Anëtarët e Këshillit Drejtues**

##### **Z. Edmond Leka**

Z. Leka ka një eksperiencë të gjatë në aktivitete të ndryshme financiare. Ai është Kryetar i Bordit Drejtues të Unionit Financiar Tiranë (UFT) që nga marsi i vitit 1998 dhe nga viti 2006 është Kryetar i Këshillit Drejtues të Bankës Union.

Z. Leka ka qenë gjithashtu Kryetar i Bordit të Drejtorëve të Bankës Italo-Shqiptare nga marsi 1996 – shkurt 2002 dhe ka kryer më parë funksionet e Kryetarit të Bordit të AMC-së (Albanian Mobile Communication) 1995-1998.

Gjatë periudhës shtator 2000-2008 z. Leka ka qenë Zëvendës-President i Dhomës Amerikane të Tregtisë në Shqipëri.

Z. Leka është gjithashtu Kryetar i Bordit të Fondacionit Harry Fultz Institute (HFI) nga viti 2003 dhe i Fondacionit të Institutit të Teknologjisë në Tiranë (TIT) nga viti 2024, të dyja këto organizata jofitimprurëse që janë të angazhuara në fushën e edukimit me fokus teknologjinë.

##### **Z. Niko Leka**

Z. Leka ka një eksperiencë të gjatë dhe solide në sektorin financiar, në menaxhim si dhe në aktivitetet e biznesit.

Aktualisht ai është nënkryetar i Bordit Drejtues i Unionit Financiar Tiranë (UFT) nga viti 2015 e në vijim dhe ka qenë Administrator prej 1996 deri në 2015.

Nga viti 2014 deri në 2017 ka mbajtur pozicionin e Kryetarit të Bordit të Drejtorëve të Landeslease.

Gjatë periudhës 1994-1995, z. Leka ka qenë Drejtor i Departamentit të Kreditit Urban (institucion mikrofinancë) në Fondin Shqiptar të Zhvillimit dhe gjatë periudhës 1999-2002 ka qenë Anëtar i Bordit Ekzekutiv të Fondit Besa (institucion financiar i mikrokredisë).

##### **Z. Varuzhan Piranjani**

Z. Piranjani ka qenë anëtar i Këshillit Drejtues të Bankës Union që nga viti 2005, Kryetar i Komitetit të Kontrollit të saj që nga viti 2007, dhe ka një eksperiencë të gjatë në fushën e biznesit, financës, bankës dhe sigurimeve. Eksperiencat e hershme të tij të punës lidhen me pozicione menaxheriale në fushën e kontabilitetit të ndërmarrjeve të ndryshme.

Në vitet 1992-2006, Z. Piranjani ka qenë në industrinë e sigurimeve si Zv.Drejtor dhe më pas si Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i Institutit të Sigurimeve (INSIG).

Aktualisht, Z. Piranjani është Anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Union Group dhe UFT.

##### **Znj. Teuta Baleta**

Znj. Baleta ka një përvojë më shumë se 20-vjeçare në mbikëqyrjen dhe rregullimin bankar dhe financiar si dhe në bankingun qëndror, në fushat e politikave dhe zhvillimet makroekonomike, stabilitetit financiar, reformimin e sektorit bankar me një fokus në privatizimin e bankave shtetërore dhe reformimin e rregullatorëve financiarë, statistikave bankare dhe makroekonomike, raportimin dhe analizat, kërkimet, qeverisjen korporative, transparencën dhe auditimin e brendshëm. Ajo ka gjithashtu një përvojë rreth 20-vjeçare si lektore në fushën e ekonomisë. Znj. Baleta aktualisht ofron shërbime konsulence për kompanitë e sektorit financiar në fushën e auditimit të brendshëm, përputhshmërisë, qeverisjes korporative, financave dhe vlerësimeve financiare. Znj. Baleta u diplomua në vitin 1993 në Financë, në Universitetin e Tiranës dhe më pas përfundoi një Master në Kontabilitet në Universitetin e Tiranës.

##### **Z. Henry Russell**

Z. Russell është anëtar i Këshillit Drejtues të Union Bank që nga muaji Gusht 2021. Ai vjen nga një eksperiencë e gjatë në pozicione drejtuese pranë disa institucioneve ndërkombëtare financiare, duke përfshirë rreth 30 vite pranë Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim.

Z. Russell ka përvojë të gjerë në fushën e investimeve në Evropën Lindore dhe Azi, duke përfshirë financimet e projekteve, huatë dhe investimet e kapitalit për sipërmarrjet private dhe publike. Gjithashtu ai është angazhuar dhe si anëtar bordi në kompani të mëdha duke kontribuar në fushën strategjike dhe qeverisjen korporative.

### **Z. Gazmend Kadriu**

Z. Kadriu është Anëtar i Këshillit Drejtues të Bankës Union që nga fillesat e saj në 2005. Gjithashtu nga 2005 deri në Shkurt 2020 ai ka qenë edhe Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i Bankës.

Z. Kadriu ka një eksperiencë gjithëpërfshirëse dhe të gjerë si një bankier, rregullator bankar dhe auditues, dhe ka fituar një eksperiencë të tillë profesionale në tre shtete të rajonit (Maqedoni, Kosove, Shqipëri).

Z. Kadriu ka një diplomë në Ekonomi nga Universiteti St. Ciril and Methodius - Shkup. Eksperiencia e tij ndër të tjera përfshin 5 vite në Departamentin e Mbikëqyrjes Bankare në Bankën Kombëtare të Maqedonisë, 1993-1998, dy vitet e fundit të së cilës ishte Drejtor i Departamentit, si dhe si Menaxher Auditimi në Ernst & Young në Shkup në vitet 2001-2004. Ai më pas e vazhdoi karrierën e tij si Drejtor Ekzekutiv dhe Anëtar i Këshillit Drejtues të Banka e Re e Kosovës.

Z. Kadriu ka qenë anëtar i Këshillit Drejtues si dhe anëtar i Komitetit të Menaxhimit të Rrezikut në Tututnska Banka a.d. Shkup në periudhën Dhjetor 2000 - Qershor 2006 si dhe ka qenë anëtar Këshilli Kujdestar dhe Zv.Kryetar i Macedonian Enterprise Development Foundation, Shkup në periudhën Dhjetor 1998 - Mars 2006.

Prej prill 2023 deri në korrik 2024, Z. Kadriu ka qenë Kryetar i Bordit udhëheqës i bankës NLB Prishtinë.

### **Z. Kreshnik Dibra**

Z. Dibra është anëtar i Këshillit Drejtues të Union Bank që nga muaji Prill 2021. Ai sjell një eksperiencë të gjerë në industri të ndryshme si auditues dhe drejtues. Për një periudhë prej 13 vitesh ka shërbyer si menaxher auditimi në kompaninë Deloitte në Shqipëri, Rumani, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe në Europën Qendrore.

Për një periudhë 2-vjeçare Z. Dibra ka mbajtur pozicionin e Drejtorit për Investimet Jokontrolluese si edhe ka qenë anëtar i Këshillit Drejtues të Grupit Balfin. Në të njëjtën kohë ka qenë anëtar i Këshillit Drejtues të Albchrome sh.a si edhe Kryetar i Këshillit Drejtues të Plus Communications dhe Insig Life.

Z. Dibra ka shërbyer si CFO pranë Grupit Infosoft për një vit si dhe si konsulent i jashtëm në projekte të Bankës Botërore dhe BERZH në Shqipëri.

Aktualisht Z.Dibra mban pozicionin e drejtuesit të raportimit financiar për Høegh LNG AS, një kompani Norvegjeze e listuar në bursën e New York.

### **Znj. Flutura Veipi (shih. Faqe 12)**

### **Z. Mërgim Cahani**

Z. Cahani, është emëruar anëtar i Këshillit Drejtues në tetor të vitit 2024. Që nga viti 2013 është themelues dhe drejtor ekzekutiv i Gjirafa Inc., ku udhëheq zhvillimin strategjik dhe operativ të kompanisë. Më parë ka punuar në institucione të ndryshme në SHBA, përfshirë Broadridge Financial Solutions dhe Morgan Stanley. Në fushën akademike, është angazhuar si profesor i shkencave kompjuterike në universitetin St. John's në Nju Jork. Z. Cahani ka përfunduar studimet Bachelor dhe MBA në St. John's University, si dhe Master në Shkenca Kompjuterike në New York University.

Përveç përvojës profesionale, z. Cahani është angazhuar, në periudha të ndryshme kohore, si anëtar bordi në disa institucione si: Dhoma Amerikane të Tregtisë në Kosovë, ATOM Institute, GAP Institute dhe Albanian Innovation Accelerator.

Në angazhimin e tij në Këshillin Drejtues, z. Cahani sjell qasje strategjike, ekspertizë të thelluar dhe kontribut të drejtpërdrejtë në vendimmarrjet e rëndësishme të institucionit.

## **Anëtarët e Komitetit të Kontrollit**

**Znj. Teuta Baleta** (shih. Faqe 10)

### **Znj. Sonila Biçaku**

Zj. Biçaku është eksperte e financës, me njohuri të gjera në fushën e biznesit dhe me një eksperiencë 22 vjeçare në ofrimin e shërbimeve të auditit, konsulencës fiskale, IFRS & UK GAAP, kontrolleve të brendshme, administrimin e rreziqeve dhe drejtimit financiar për shumë kompani e organizata kombëtare e ndërkombëtare.

Ajo është anëtare e ACCA (Shoqatës së Kontabilistëve të Miratuar në Britaninë e Madhe) nga Prill 2004 dhe anëtare e Institutit të Eksperteve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë nga Korrik 2012.

Zj. Biçaku punon aktualisht si konsulente financiare dhe konsulente në fushën e qeverisjes së korporatave. Më parë ajo ka punuar si Menaxhere në Deloitte dhe International Finance Corporation në Shqipëri.

**Z. Kreshnik Dibra** (shih. Faqe 11)

## **Anëtarët e Drejtorisë Ekzekutive**

### **Znj. Flutura Veipi**

Znj. Veipi është Drejtore e Përgjithshme Ekzekutive dhe Kryetare e Drejtorisë Ekzekutive e Union Bank dhe Anëtare e Këshillit Drejtues.

Znj. Veipi ka një eksperiencë të kalibrit ekzekutiv me mbi njëzet vjet eksperiencë në fushën bankare, financiare, atë të investimeve dhe projekteve në menaxhim strategjik dhe lidhshëm. Gjatë viteve 2000-2014 ajo ka punuar ProCredit Bank Albania, ku ka mbajtur disa pozicione kyçe drejtuese, në përfundim dhe atë të Anëtares së Këshillit Drejtues të Bankës.

Eksperiencia dhe ekspertiza të tjera të Znj. Veipi përfshijnë edhe pozicione të tjera të rëndësishme e të nderuara si Anëtare e Këshillit Drejtues të Dhomës Amerikane të Tregtisë dhe Kryetare e Komitetit të “Woman Active in Business” në periudhën 2012-2014. Gjithashtu ka qenë Anëtare e Këshillit Ekzekutiv të Shoqatës Shqiptare të Bankave në periudhën 2011-2013, si dhe nga viti 2019 e në vazhdim. Znj. Veipi është diplomuar në Financë dhe Kontabilitet nga Universiteti i Tiranës në vitin 2000, si dhe ka një certifikatë në MBA në Universitetin e Roehampton, Londër, 2017.

### **Znj. Suela Bokshi**

Znj. Bokshi është Anëtare e Drejtorisë Ekzekutive prej Tetor 2024 dhe Drejtore e Divizionit të Operacioneve të Bankës Union që nga Korrik 2005. Nga Mars 2020 deri në Tetor 2024 ka qenë dhe Zv. Drejtore e Përgjithshme Ekzekutive në Bankën Union.

Znj. Bokshi ka një eksperiencë afatgjatë në bankë. Ajo u diplomua në Financë dhe Bankë, në Universitetin e Tiranës dhe vazhdoi një Master në Bankë dhe Financë për Vendet e Europës Lindore në “Giordano Del’ Amore Foundation” dhe CARIPO Bank, në Milano, Itali. Znj. Bokshi filloi karrierën e saj në Bankën Kombëtare Tregtare në 1995. Në 1997 ajo punoi në Bankën e Shqipërisë si Drejtore e Departamentit të Pagesave. Në vitin 2000 ajo mbajti pozicionin e Drejtorit të Thesarit dhe Pagesave dhe më vonë atë të Drejtorit Operacional në Bankën ProCredit në Shqipëri.

## **Z. Arten Zikaj**

Z. Zikaj është Anëtar i Drejtorisë Ekzekutive prej Tetor 2024 dhe Drejtor i Divizionit të Financës në Bankën Union që nga Mars 2011. Z. Zikaj ka një eksperiencë të gjerë në kontabilitetin, raportimin dhe analizën financiare, auditimin lokal dhe ndërkombëtar të institucioneve financiare, kompanive të sigurimit dhe ndërmarrjeve komerciale, ekspertizë në SNRF-të, menaxhimin e rrezikut, operacioneve të thesarit, etj. Për disa vite ai ka qenë dhe lektor me kohë të pjesshme në Universitetin e Tiranës, Fakultetin e Ekonomisë.

Z. Zikaj u diplomua në Menaxhim Biznesi në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës. Ai punoi për rreth 7 vite në auditim në KPMG, duke mbërritur në pozicionin e Menaxher i ngarkuar për auditimin dhe më pas në konsulencë financiare për industri të ndryshme në Shqipëri dhe Kosovë. Në vitin 2004 ai ka qenë Zv. Drejtor i Financës në Bankën ProCredit në Shqipëri dhe në 2007-2010 ka punuar në KEP Trust, një institucion mikrofinanciar në Kosovë, si Zv. Drejtor Ekzekutiv për Financën dhe Thesarin.

## **Z. Alban Burazeri**

Z. Burazeri është Anëtar i Drejtorisë Ekzekutive prej Tetor 2024 dhe Drejtor i Transformimit dhe Inovacionit që prej Qershor 2023, kohë në të cilën edhe iu bashkua Union Bank. Ai ka një eksperiencë profesionale prej më shumë se 3 dekadash nga të cilat mbi 27 vjet në sistemin bankar. Pjesën më të qenësishme të karrierës së tij Z. Burazeri e ka në Alpha Bank Albania ku që prej vitit 2006 deri në 2022 ka qenë anëtar i Drejtorisë Ekzekutive duke drejtuar njëkohësisht edhe Njësinë e Biznesit të Operacioneve dhe IT.

Z. Burazeri është diplomuar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, dega Informatikë. Gjithashtu ka diplomë Master dhe Doktor i Shkencave në Informatikë po nga i njëjti universitet dhe fakultet.

## **Drejtorët e Divizioneve**

**Znj. Suela Bokshi** (shih. Faqe 12)

**Z. Arten Zikaj** (shih. Faqe 13)

**Z. Alban Burazeri** (shih. Faqe 13)

## **Znj. Enkeleda Hasho**

Znj. Hasho është Drejtor i Divizionit të Klientëve Biznes nga Qershori 2019 dhe që nga viti 2012 deri në këtë datë ka mbajtur pozicionin e Drejtorit të Divizionit të Kredisë në Bankën Union. Eksperienca e Znj. Hasho vjen nga një formim i gjatë dhe solid në financë dhe bankë. Para këtij pozicioni në Bankën Union, Znj. Hasho ka punuar si Drejtore e Departamentit të Kredisë në Bankën Ndërkombëtare Tregtare (ICB) në vitet 2000-2005. Znj. Hasho ka një ekspertizë të vlefshme në procesin e zhvillimit të strategjisë së kreditimit tregtar bazuar në produktet e kredisë.

Znj. Hasho u diplomua në Menaxhim Biznesi në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës dhe gjithashtu ka një MBA nga Universitas Fabrefacta Optime University, Tiranë.

## **Z. Gent Drita**

Z. Drita është Drejtor i Divizionit të Rrezikut të Kredisë në Bankën Union që nga Korrik 2019. Z. Drita ka një eksperiencë të gjatë në fushën e kredidhënies duke filluar karrierën e tij nga pozicioni i specialistit të kredisë duke kaluar më tej në pozicione drejtuese në shitje dhe në rrezikun e kredisë.

Z. Drita u diplomua në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës dhe mban një diplomë Master për Studimet Ekonomike Europiane. Ai punoi për rreth 5 vjet në NBG Bank dhe në ProCredit Bank në fushën e kredidhënies dhe më pas në Bankën Union ku për shumë vite është angazhuar me shitjen e produkteve

ndaj bizneseve, në drejtimin e Departamentit të Shitjes dhe më pas në Departamentin e Rrezikut të Kredive për Biznes.

**Znj. Irena Rushaj**

Znj. Rushaj është Drejtore e Divizionit të IT që prej Nëntor 2022. Ajo ka një eksperiencë 24 vjecare në sistemin bankar me fokus në Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit. Znj. Rushaj ka filluar karrierën e saj në Bankën Amerikane të Shqipërisë duke marrë në pak vite rol drejtues në zhvillimin e kanaleve alternative bankare dhe platformës digjitale. Që nga Mars 2005 ajo ka Drejtuar Departamentin e IT në Union Bank.

Znj. Rushaj është diplomuar në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës. Ajo mban një Diplome Master i Shkencave në Informatikë nga i njëjti Universitet. Ajo mban gjithashtu një Diplomë Master në Administrim Biznesi nga Universiteti New York në Tiranë.

**Z. Armald Imeraj**

Z. Imeraj është Drejtor i Divizionit të Ofrimit të Proceseve të Biznesit dhe Inovacionit që prej Nëntor 2025. Ai ka një eksperiencë mbi 20 vjeçare në sistemin bankar me fokus në Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit. Z. Imeraj ka filluar karrierën e tij në Universitetin e Tiranës, duke marrë shumë shpejt rol drejtues të Departamentit IT. Ne 2003 ka filluar karrierën në Bankën Amerikane të Shqipërisë. Që nga Gushti 2005 ai është pjesë e IT të Union Bank, duke mbajtur role drejtuese.

Z. Imeraj është diplomuar në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës. Ai mban një Diplomë Master i Shkencave në Informatikë nga i njëjti Universitet.

### **1.3.3 Informacion mbi kodin e etikës në Bankën Union**

Kodi i Etikës përcakton standardet për komunikimin dhe sjelljen në marrëdhëniet me klientët, furnitorët, punonjësit dhe organet rregullatore. Ai ofron udhëzime për sjelljen e pritur në të gjitha aktivitetet e bankës. Çdo punonjës ka përgjegjësinë personale për të lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e Kodit dhe për të vepruar në përputhje me të. Nëse ka ndonjë paqartësi, punonjësit duhet të konsultohen me drejtuesin e tyre ose Departamentin e Burimeve Njerëzore.

#### **Deklarata e Politikës së Përputhshmërisë**

Banka është e angazhuar të punojë me integritet dhe përgjegjësi, duke respektuar kërkesat ligjore dhe rregullatore. Kjo përfshin veprimin në mënyrë të ndershme dhe të drejtë në të gjitha marrëdhëniet me klientët, furnitorët, punonjësit dhe organet rregullatore. Synimi është të ruhet reputacioni dhe integriteti i bankës, të krijohet besim tek banka dhe të evitohen kostot dhe publiciteti negativ që shoqëron mungesën e përputhshmërisë.

#### **Përgjegjësitë Personale**

Punonjësit duhet të veprojnë me integritet dhe ndershmëri në të gjitha aktivitetet me klientët dhe palët e tjera të lidhura me bankën. Ata janë të detyruar të raportojnë çdo shkelje të Kodit ose politikave të tjera të bankës. Konfliktet e interesit duhet të evitohen dhe menaxhohen me kujdes për të siguruar që interesat personale të mos ndërhyjnë me ato të bankës.

#### **Interesat e Jashtme dhe Private**

Punonjësit janë të inkurajuar të marrin pjesë aktive në komunitetet ku jetojnë dhe punojnë, por çdo përfshirje në biznes jashtë bankës kërkon miratim paraprak me shkrim. Angazhimet politike duhet të jenë të tilla që të mos dëmtojnë interesat e bankës dhe të mos krijojnë perceptimin e një lidhjeje të bankës me ndonjë parti politike specifike.

#### **Marrëdhëniet me Palët e Lidhura**

Punonjësit nuk duhet të pranojnë dhurata, sponsorizime, ftesa ose përfitime të tjera që mund të ndikojnë vendimmarrjen e tyre në bankë. Punësimi i të afërmeve nuk inkurajohet, veçanërisht në të njëjtën degë ose departament, për të shmangur konfliktet e interesit.

#### **Financat Personale**

Punonjësit duhet të menaxhojnë financat e tyre personale me kujdes për të shmangur situata që mund të ndikojnë negativisht në bankë. Ata duhet të jenë të vetëdijshëm për risqet e ndermarrjes së detyrimeve të mëdha financiare dhe të plotësojnë detyrimet e tyre financiare në mënyrë të rregullt.

#### **Marrëdhëniet me Konkurrentët**

Punonjësit duhet të shmangin deklaratat që vënë në pikëpyetje sjelljen profesionale të konkurrentëve të bankës. Në përpjekjet për të tërhequr biznes, ata mund të reklamojnë avantazhet e shërbimeve të ofruara nga banka, por jo dobësitë e konkurrentëve.

#### **Pasuria e Bankës**

Punonjësit kanë përgjegjësinë të ruajnë pasurinë e bankës dhe ta përdorin atë për qëllimet e duhura. Pasuria e bankës përfshin të gjitha pasuritë fizike, softwaret, dokumentacionin dhe materialet promocionale.

#### **Zbatimi i Kodit**

Punonjësit janë përgjegjës për njohjen e përmbajtjes së Kodit dhe për ndjekjen e standardeve të detajuara në të. Ata duhet të raportojnë çdo shkelje të paqëllimshme menjëherë dhe të sigurojnë që të gjitha veprimet e tyre janë në përputhje me Kodin.

#### **Informacioni Konfidencial**

Punonjësit duhet të trajtojnë të gjithë informacionin e marrë gjatë punësimit si konfidencial dhe ta përdorin atë vetëm për qëllime pune. Informacioni konfidencial nuk duhet të diskutohet jashtë bankës dhe duhet të mbrohet në përputhje me legjislacionin dhe politikat e brendshme të bankës.

**Dhënia e Këshillimeve/Konsulencës**

Vetëm punonjësit e kualifikuar dhe të autorizuar duhet të japin këshilla ligjore, tatimore ose investimi për klientët. Klientët duhet të orientohen të kërkojnë konsulencë nga profesionistë të kualifikuar.

**Veprimet Bankare**

Të gjitha veprimet bankare të punonjësve duhet të lidhen me qëllimet dhe financat personale dhe të kryhen në përputhje me kushtet dhe procedurat e bankës. Llogaritë personale nuk duhet të përdoren për qëllime biznesi.

**Deklaratat**


Punonjësit duhet të deklarojnë se kanë lexuar dhe kuptuar Kodin dhe të raportojnë çdo konflikt të mundshëm interesi.

**1.3.4 Informacion mbi strukturën e grupit të konsoliduar**

Unioni Financiar Tiranë shpk (“UFT” ose “Kompania Mëmë”) është një kompani me përgjegjësi të kufizuar, regjistruar në bazë të vendimit No. 9406, datë 6 Mars 1995. UFT është Përfaqësues Kontraktual i Western Union Financial Services INC. Selia e UFT-se është në Rrugën “Ismail Qemali”, Numri 32, Kati 3 Tiranë.

UFT ka në pronësi filialet e mëposhtme:

- **Union Bank Sh.a.**, duke zotëruar 96.46% të aksioneve të saj;
- **Unioni financiar Prishtinë Shpk. (“UFP”)**, i cili është një kompani me përgjegjësi të kufizuar 80.00% i kontrolluar nga UFT i cili ushtron aktivitetin e vet në Kosovë. UFP e ka filluar aktivitetin e tij në 1 Janar 2013 dhe është Përfaqësues Kontraktual i Western Union Financial Services INC. Selia e UFP është në Rr. Perandori Justinian 1E, Qyteza Pejton, Prishtina, Kosovo;
- **Unija Financiska Skopje DOO (“UFS”)**, i cili është një kompani me përgjegjësi të kufizuar i themeluar në Republikën e Maqedonisë me vendim të Gjykatës së Shkupit Nr.5710/03, datë 16 Janar 2004. UFT zotëron 75.04% të kapitalit aksionar të tij. UFS është Përfaqësues Kontraktual i Western Union Financial Services INC.
- **Union of Financial Corners (“UFC”)**, i cili u themelua më 1 Maj 2005 në Gjenevë, Zvicër. UFT zotëron 51.00% të kapitalit aksionar të tij. UFC është Përfaqësues Kontraktual i Western Union në Zvicër.
- **Paylink Sha. (“Paylink”)** e cila është një kompani financiare e licensuar nga Banka e Shqipërisë për të kryer shërbimet e procesimit të kartave si dhe shërbimeve të tjera lidhur me to. Investimi në kompaninë Paylink është bërë me 3 Shtator 2012. UFT zotëron 100.00% të kapitalit të Paylink.
- **Auto City Sha.** Investimi në Auto City është bërë në 26 Dhjetor 2012 . UFT zotëron 100.00% të aksioneve në kapitalin e Auto City.
- **Union Net Kroaci** i cili u themelua më 10 Mars 2016 në Zagreb, Kroaci. UFT zotëron 100.00% të kapitalit të tij aksionar. Union Net Kroaci është Përfaqësues Kontraktual i Western Union Financial Services INC.
- **Landeslease sh.a.** Që prej fundit të vitit 2023 zotëron 19% të Filialit të Bankës/Emetuesit (për më shumë detaje paragrafët në vijim).



Skema e Grupit sipas datës 31 Mars 2026.

## 1.4 Informacion mbi filialet e Bankës

Banka, në 22 Dhjetor 2014, bleu 100% të aksioneve të Landeslease sha (“LL”). LL është një shoqëri shqiptare e cila ushtron aktivitetin e qirasë financiare, e regjistruar si një shoqëri aksionare, e cila filloi të operonte në 5 Prill 2005. Selia e Landeslease sha është në Tiranë, Rruga “Ismail Qemali”.

Gjatë vitit 2023, pas marrjes së vendimeve të strukturave respektive të brendshme si dhe me miratimin e Bankës së Shqipërisë, Unioni Financiar Tiranë Sh.p.k iu shtua strukturës aksionare të LL nëpërmjet blerjes së aksioneve të reja të emetuara. Pas kësaj, Banka zotëron 81% të aksioneve të Filialit.

Landeslease paraqet një komponent të rëndësishëm të strategjisë së Grupit për diversifikimin e produkteve financiare dhe ka rezultuar me performancë pozitive ndër vite, duke kontribuar në mënyrë të vazhdueshme me dividendë për Bankën.

Në datën 31 mars 2026, investimi i Bankës në Landeslease paraqitet në vlerën 460,671 mijë Lekë (2025: 460,761 mijë Lekë). Në të njëjtën datë, kapitali aksionar i shoqërisë, i nënshkruar dhe i shlyer tërësisht, është 620,000 mijë Lekë. Gjithashtu, Banka ka akorduar kredi ndaj Landeslease në shumën totale prej 30.7 milionë Euro, në përputhje me limitet rregullatore dhe të brendshme për këtë ekspozim.

Gjatë vitit 2025, Banka realizoi gjithashtu një hap të rëndësishëm strategjik përmes blerjes së 100% të aksioneve të Albanian Financial Institution (AFI), institucion financiar jo-bankar i licencuar dhe i mbikëqyrur nga Banka e Shqipërisë. Marrëveshja për blerjen e aksioneve u nënshkrua më 28 mars 2025, ndërsa miratimi rregullator për transaksionin u mor më 2 tetor 2025.

AFI zotëron një licencë të plotë për ushtrimin e aktivitetit financiar jo-bankar, duke krijuar mundësi për zgjerimin e aktiviteteve të Grupit në segmentet e mikrokredisë, huadhënies konsumatore dhe produkteve të specializuara financiare.

Në datën 31 mars 2026, investimi i Bankës në AFI paraqitet në vlerën 332,284 mijë Lekë. Gjithashtu, Banka ka akorduar kredi ndaj AFI në shumën totale prej 85.4 milionë Lekë, në përputhje me limitet rregullatore dhe të brendshme për këtë ekspozim.

## 1.5 Informacion për aktivitetet e Bankës

Veprimtaria kryesore e Bankës është aktiviteti bankar, të pranojë depozita të çdo lloji me ose pa interes, të ushtrojë aktivitetin kreditues duke përfshirë kredinë e konsumit, kredinë hipotekore, financimin e bizneseve dhe transaksioneve të ndryshme tregtare, të marrë hua, të blejë apo të shesë për llogari të saj dhe të klientëve instrumente të tregut të parasë letra me vlerë të borxhit, kontrata të së ardhmes dhe kontrata me kusht. Të ofrojë shërbimin e pagesave dhe të arkëtimeve; të emetojë, të pranojë dhe të administrojë mjete të pagesave; të ndërmeretësojë për transaksione monetare; të ushtrojë qira financiare.

Bazuar në licencën nga Banka e Shqipërisë, Union Bank Sh.a. është e licencuar për të kryer veprimtari bankare dhe financiare si më poshtë:

- 1) Të gjitha format e kredidhënies, duke përfshirë edhe kredinë konsumatore dhe kredinë hipotekore;
- 2) Qiranë financiare;
- 3) Të gjitha shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave;
- 4) Ofrimin e garancive;
- 5) Tregtimin për llogari të saj ose për llogari të klientëve, qoftë dhe në një këmbim valutor, në një treg të vetorganizuar (OTC) ose ndryshe, si më poshtë:
  - a. instrumente të tregut të parasë (çeqe, dëftesa, certifikata të depozitave etj.)
  - b. këmbim valutor;
  - c. instrumente të këmbimeve valutore dhe instrumente të vlerësimit të normës së interesit, duke përfshirë këtu produkte të tilla, si marrëveshje *swap* dhe marrëveshje që përcaktojnë vlerën e interesit në të ardhmen.
  - d. të letrave me vlerë të transferueshme
- 6) Ofrimin e shërbimit të kasave të sigurimit;
- 7) Emetimin dhe administrimin e instrumenteve të pagesës (të tilla si kartat e kreditit dhe të debitit, çeqet e udhëtarit dhe çeqet bankare, kartat e pagesës dhe pagesat me celular), etj., përfshirë emetimin e parasë elektronike;

- 8) Ndërmjetësim për transaksionet monetare të marrjes në kujdestari;
- 9) Shërbimet këshilluese, ndërmjetëse dhe shërbimet e tjera ndihmëse për të veprimtaritë e listuara më sipër;
- 10) Shërbimet e pagesave, të listuar nga pika 1 deri në pikën 8 të Aneksit 1 të ligjit nr.55, datë 30.04.2020 “Për shërbimet e pagesave: si vijon:
  - 10.1 Shërbimet që mundësojnë depozitimin e parave fizike në një llogari pagese, si dhe të gjitha veprimet e nevojshme për funksionimin e një llogarie pagese,
  - 10.2 Shërbimet që mundësojnë tërheqjen e parave fizike nga një llogari pagese, si dhe të gjitha veprimet e nevojshme për funksionimin e një llogarie pagese,
  - 10.3 Ekzekutimi transaksioneve të pagesave, duke përfshirë transferimet e fondeve në një llogari pagesash të çelur pranë ofruesit të shërbimit të pagesave të përdoruesit ose pranë një ofruesi tjetër të shërbimit të pagesave:
    - a) ekzekutimi i debitimeve direkte, duke përfshirë dhe debitimet direkte që bëhen vetëm një herë,
    - b) ekzekutimi i transaksioneve të pagesave përmes një karte pagese ose nga një pajisje e ngjashme,
    - c) ekzekutimi i transfertave të kreditit, duke përfshirë pagesat periodike
  - 10.4 Ekzekutimi i transaksioneve të pagesave, ku fondet janë të mbuluara nga një linjë kredie për një përdorues të shërbimit të pagesave:
    - a) ekzekutimi i debitimeve direkte, duke përfshirë debitimet direkte që bëhen vetëm një herë,
    - b) ekzekutimi i transaksioneve të pagesave përmes një karte pagese ose nga një pajisje e ngjashme,
    - c) ekzekutimi i transfertave të kreditit duke përfshirë pagesat periodike.
  - 10.5 Emetimi i një instrumenti pagese dhe/ose pranimi i transaksioneve të pagesave,
  - 10.6 Dërgesat e parave,
  - 10.7 Shërbimi i inicimit të pagesës
  - 10.8 Shërbimi i informimit të llogarisë

Bazuar në licencën nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me vendim Bordi nr. 7, date 31.01.2022 të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Banka është e licencuar për të kryer veprimtari e Shoqërisë komisionere si më poshtë:

1. Shoqëri për ofrimin e shërbimeve të investimit:
  - a. Marrje dhe transmetim i urdhrave për një ose më shumë instrumente financiare;
  - b. Ekzekutim i urdhrave në emër të klientëve;
  - c. Tregtim për llogari të vet; në lidhje me këto instrumente financiare:
    - i. titujt e transferueshëm;
    - ii. instrumentet e tregut të parasë.
2. Shoqëri për ofrimin e shërbimit ndihmës: Ruajtja dhe administrimi i instrumenteve financiare në emër të klientëve, për instrumentet financiare të parashikuara tek shërbimet e investimit.

Banka ushtron të gjitha veprimtaritë sipas licencës me përjashtim të ofrimit të shërbimit të qirasë financiare (të cilin e ushtron nëpërmjet Filialit).

## **2. Bilanci kontabël, Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve, Tregues të rentabilitetit**

### **2.1 Analiza dhe komente përmbledhëse për ecurinë e gjendjes financiare të Bankës**

Kthimi në Kapitalin (ROE) aksionar mesatar rezultoi të jetë në nivelin 14.1% dhe Kthimi në Aktivet mesatare (ROA) është 1.2%. Likuiditeti mbetet përtej limiteve të vendosura nga Banka e Shqipërisë dhe limiteve të brendshme, që janë më prudenste dhe në total raporti i likuiditetit është 34.8%.

Raporti i Kredive me Probleme ndaj Totalit të Portofolit Bruto (“NPL”) është 4.8%, duke mbetur në nivele të ulëta e të qëndrueshme.

### **Bilanci i Aktiveve dhe Pasiveve të Bankës në Mars 2026 (detajuar në seksionin 2.2)**

**Aktivitet:** Në fund të Mars 2025 janë përafërsisht **121.7 Miliardë Lekë**, rreth 0.9 Miliardë Lekë ose 0.7% më e lartë se balanca në fund të vitit 2025. Portofoli Hua ndaj Klientëve dhe Institucioneve Financiare, u rrit me 3.4 Miliardë Lekë ose rreth 5.7%; nga të cilat mbi 3.8 Miliardë Lekë është në Huat ndaj Klientëve ndërsa Huat ndaj Institucioneve Financiare u ulën me vetëm 0.4 Miliardë Lekë.

Investimet në Letra me Vlerë pësuan një rënie me ~1.8 Miliardë Lekë; Bonot e Thesarit të Qeverisë Shqiptare u ulën me ~0.6 Miliardë Lekë ndërsa investimet në Obligacione të Qeverisë dhe Letra me Vlerë të Huaja u ulën me 1.2 Miliardë Lekë apo 3.2%. Arka dhe Banka Qëndrore ka një rënie me ~2.8 Miliardë Lekë, ndërsa Llogaritë dhe Depozitat në Bankat dhe Institucionet Financiare kanë një rritje me 1.9 Miliardë Lekë.

Banka ruan një strukturë të qëndrueshme të përfitueshmërisë, duke garantuar nga ana tjetër mjete likuide në nivelet e duhura për ushtrim të aktivitetit të saj dhe ruajtjes së parametrave mjaft të mirë të likuiditetit.

**Detyrimet:** Në total rritja është me afro 0.5 Miliardë Lekë ose 0.5% më shumë se Dhjetor 2025. Veprimet me Klientët ose Fondet u rritën me 1.4 Miliardë Lekë ose 1.6%. Detyrimet ndaj klientëve për llogaritë rrjedhëse, që janë nën këtë zë, u rritën me 1.4 Miliardë Lekë ose 5.1% dhe përbëjnë 103.8% të rritjes së Fondeve. Depozitat pa afat u rritën me 0.5 Miliardë Lekë ndërsa Depozitat me afat tregojnë rënie me 0.1 Miliardë Lekë ose 0.2%.

Detyrimet ndaj Bankave dhe Institucioneve Financiare tregojnë rritje me 0.3 Miliardë Lekë; ndërsa Detyrimet ndaj Bankës Qëndrore, që konsistojnë në hua afatshkurtra kryesisht në formën e marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes (Repos), patën një rënie me 1.3 Miliardë Lekë. Gjatë tremujorit të parë të vitit 2026, banka shleu një pjesë të borxhit të varur (ne maturim te tij), duke e ulur atë me rreth 0.2 miliardë lekë.

**Kapitali i Aksionarëve** tregoi një rritje prej ~0.3 Miliardë Lekë ose 3.3% më lart se Dhjetor 2025, që vjen nga fitimi i periudhës së raportuar.

### **Të Ardhurat dhe Shpenzimet nga veprimtaria kryesore (detajuar në seksionin 2.3)**

**Fitimi Neto** i periudhës tregon **0.4 Miliardë Lekë**, i cili është 10.6 Milionë Lekë ose 3.0% më shumë se tremujori i parë i vitit 2025, e cila rezulton kryesisht nga rritja e të ardhurave operative.

Ndryshimi i Fitimit për tremujorin e vitit ushtrimor vjen si kombinim i:

a) *Totali i të Ardhurave Operative* është më i lartë me 109.0 Milionë Lekë apo 8.6% kundrejt të njëjtës periudhë të vitit të mëparshëm, si rezultat i:

- i. Të ardhurat Neto nga Interesat paraqesin një rritje prej 98.3 Milionë Lekë ose 10.1%;
- ii. Të ardhurat nga Komisionet neto janë afro 18.8 Milionë Lekë ose 10.3% më shumë;
- iii. Të ardhurat nga veprimtaritë e tjera bankare janë 32.5 Milionë Lekë më pak.

Në strukturën totale të të ardhurave, Të ardhurat Neto nga Interesat kanë një rritje rreth 1.0% (dhe përbëjnë 78.2% të të ardhurave krahasuar me 77.2% të së njëjtës periudhë të 2025), Të ardhurat nga Komisionet neto kanë një rënie me 0.2% (përbëjnë 14.7% të totalit) ndërsa Të ardhurat e tjera janë ulur me 1.2% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të mëparshëm.

b) *Shpenzimet Operative*, përfshirë dhe fondet rezervë për huat dhe amortizimin, janë ~1.0 Miliardë Lekë; 104.8 Milionë Lekë më shumë se e njëjta periudhë e vitit të mëparshëm. Variancat më të mëdha në këtë grup shpenzimesh vijnë kryesisht nga:

- i. Shpenzime të Përgjithshme të Veprimtarisë 92.6 Milionë Lekë më shumë,
- ii. Shpenzimet për Personelin rritje me 33.9 Milionë Lekë,
- iii. Shpenzimet për Fondet Rezervë për huat janë 33.3 Milionë Lekë më pak,
- iv. Shpenzimet për Fondet Rezervë të tjera paraqesin 6.2 Milionë Lekë më pak.

## 2.2 Bilanci Individual Kontabël

Në Mijë Lekë	31 Mars 2026	31 Dhjetor 2025	Ndryshimi	ne %
<b>Aktivët</b>				
Arka dhe Banka Qendrore	11,541,898	14,329,362	(2,787,464)	-19.5%
Bono thesari	770,264	1,375,585	(605,321)	-44.0%
Hua dhe paradhënie neto për IF	13,016,446	11,484,952	1,531,494	13.3%
<i>Llogari rrjedhëse</i>	3,067,336	606,489	2,460,847	405.8%
<i>Depozita</i>	5,006,999	5,541,559	(534,560)	-9.6%
<i>Hua</i>	4,478,768	4,873,269	(394,501)	-8.1%
<i>Llogari të tjera</i>	464,024	463,635	389	0.1%
<i>minus fonde rezervë për llogaritë IFI</i>	(681)	-	(681)	
Hua dhe paradhënie neto për klientët	58,624,586	54,850,486	3,774,100	6.9%
<i>Hua dhe paradhënie standarte</i>	55,666,085	51,721,765	3,944,320	7.6%
<i>Hua dhe paradhënie në ndjekje</i>	1,784,257	2,207,674	(423,417)	-19.2%
<i>Hua nenstandart</i>	990,137	606,906	383,231	63.1%
<i>Hua të dyshimta</i>	1,251,289	1,386,019	(134,730)	-9.7%
<i>Hua të humbura</i>	880,417	819,636	60,781	7.4%
<i>minus fondet rezervë për huatë</i>	(1,947,599)	(1,891,514)	(56,085)	3.0%
Letra me vlerë me të ardhura fikse	34,937,306	36,103,674	(1,166,368)	-3.2%
Filiale	792,955	792,955	-	0.0%
Mjete të qëndrueshme, neto	1,281,431	1,180,065	101,366	8.6%
Mjete të tjera, neto	732,067	713,371	18,696	2.6%
<b>Totali i Aktiveve</b>	<b>121,696,954</b>	<b>20,830,450</b>	<b>866,503</b>	<b>0.7%</b>
<b>Detyrimet</b>				
Detyrime ndaj Bankës Qendrore	8,992,791	10,295,120	(1,302,329)	-12.6%
Detyrime ndaj bankave dhe IF	10,088,579	9,798,691	289,888	3.0%
Veprime me klientët	88,431,728	87,045,645	1,386,083	1.6%
<i>Qeveria shqiptare e admin publike</i>	248,751	180,902	67,849	37.5%
<i>Llogaritë rrjedhëse</i>	29,856,098	28,417,172	1,438,926	5.1%
<i>Depozita pa afat</i>	11,966,074	11,900,646	65,428	0.5%
<i>Depozita me afat</i>	45,357,690	45,458,173	(100,483)	-0.2%
<i>Llogari të tjera</i>	1,003,115	1,088,752	(85,637)	-7.9%
Fond rezervë statistikore për huat	665,851	651,308	14,543	2.2%
Detyrime të tjera	919,141	581,915	337,225	58.0%
Borxhi i varur	1,802,561	2,006,593	(204,032)	-10.2%
<b>Totali i Detyrimeve</b>	<b>110,900,651</b>	<b>110,379,272</b>	<b>521,378</b>	<b>0.5%</b>
<b>Totali i kapitalit aksionar</b>	<b>10,796,303</b>	<b>10,451,178</b>	<b>345,125</b>	<b>3.3%</b>
<b>Totali i detyrimeve dhe kapitalit</b>	<b>121,696,954</b>	<b>120,830,450</b>	<b>866,503</b>	<b>0.7%</b>
<b>Zërat jashtë bilancit</b>				
Angazhime të dhëna	3,731,776	4,658,678	(926,902)	-19.9%
Angazhime të marra	-	145,155	(145,155)	-100.0%
Garanci të dhëna	742,133	698,866	43,267	6.2%
Garanci të marra	148,541,429	146,719,416	1,822,013	1.2%
Veprime valutore (të blera - të shitura)	5,989	830	5,159	621.6%

## 2.3 Pasqyra Individuale e Të Ardhurave dhe Shpenzimeve

Në Mijë Lekë	31 Mars 2026	31 Mars 2025	Ndryshimi	në %
<b>Të ardhura nga interesat</b>	<b>1,484,093</b>	<b>1,347,974</b>	<b>136,119</b>	<b>10.1%</b>
<i>Për veprimet e thesarit</i>	102,875	122,676	(19,801)	-16.1%
<i>Nga veprimet me klientët</i>	930,094	781,974	148,120	18.9%
<i>Nga veprimet me letrat me vlerë dhe veprimtaritë e tjera financiare</i>	428,669	419,502	9,167	2.2%
<i>Të tjera</i>	22,455	23,822	(1,367)	-5.7%
<b>Shpenzime për interesat</b>	<b>(410,971)</b>	<b>(373,184)</b>	<b>(37,787)</b>	<b>10.1%</b>
<i>Për veprimet e thesarit</i>	(45,743)	(42,890)	(2,853)	6.7%
<i>Për veprimet me klientët</i>	(277,382)	(268,069)	(9,313)	3.5%
<i>Për borxhet e varura</i>	(23,622)	(16,302)	(7,320)	44.9%
<i>Për letrat me vlerë dhe veprimtaritë e tjera financiare</i>	(64,224)	(45,923)	(18,301)	39.9%
<i>Të tjera</i>				
<b>Të ardhurat nga interesat, neto</b>	<b>1,073,122</b>	<b>974,790</b>	<b>98,332</b>	<b>10.1%</b>
			-	
<b>Të ardhura nga komisione</b>	<b>237,277</b>	<b>210,929</b>	<b>26,348</b>	<b>12.5%</b>
<i>Nga veprimet e thesarit</i>	259	553	(294)	-53.2%
<i>Nga transaksionet me klientët</i>	67,772	48,312	19,460	40.3%
<i>Komisione për shërbimet bankare</i>	156,926	151,257	5,669	3.7%
<i>Komisione të tjera</i>	12,320	10,807	1,513	14.0%
<b>Shpenzime për komisione</b>	<b>(35,021)</b>	<b>(27,489)</b>	<b>(7,532)</b>	<b>27.4%</b>
<i>Për veprimet e thesarit</i>	(3,467)	(4,220)	753	-17.8%
<i>Komisione për shërbime bankare</i>	(31,542)	(23,257)	(8,285)	35.6%
<i>Komisione të tjera</i>	(12)	(12)	-	0.0%
<b>Të ardhura nga komisionet, neto</b>	<b>202,256</b>	<b>183,440</b>	<b>18,816</b>	<b>10.3%</b>
Fitim/Humbje nga veprimtaritë e qirasë, neto	3,574	2,850	724	25.4%
Fitim/Humbje nga veprimtaritë e tjera bankare, neto	14,942	47,418	(32,476)	-68.5%
Fitim/Humbje nga veprimet me valutat, neto	78,221	54,661	23,560	43.1%
<b>Totali i të ardhurave operative</b>	<b>1,372,115</b>	<b>1,263,159</b>	<b>108,956</b>	<b>8.6%</b>
Shpenzime për personelin	(374,224)	(340,337)	(33,887)	10.0%
Taksa të tjera përveç taksave mbi të ardhurat	(12)	(21)	9	-42.9%
Shpenzime të përgjithshme të veprimtarisë	(448,133)	(355,516)	(92,617)	26.1%
Amortizimi i mjeteve të qëndrueshme	(76,951)	(59,173)	(17,778)	30.0%
Shpenzime për fonde rezervë për huatë	(80,400)	(113,666)	33,266	-29.3%
Shpenzime për fonde rezervë të tjera	8,238	1,992	6,246	313.6%
<b>Totali i shpenzimeve operative</b>	<b>(971,482)</b>	<b>(866,721)</b>	<b>(104,761)</b>	<b>12.1%</b>
Veprimtaritë e jashtëzakonshme	18,371	15,550	2,821	18.1%
<b>Fitimi para tatimit</b>	<b>419,004</b>	<b>411,988</b>	<b>7,015</b>	<b>1.7%</b>
Tatimi mbi fitimin	(49,903)	(53,532)	3,629	-6.8%
<b>Fitimi neto për periudhën</b>	<b>369,101</b>	<b>358,456</b>	<b>10,644</b>	<b>3.0%</b>

## 2.4 Tregues të rentabilitetit të Bankës<sup>1</sup>:

	31 Mars 2026	31 Dhjetor 2025	30 Shtator 2025	30 Qershor 2025	31 Mars 2025	31 Dhjetor 2024
1. Kthyeshmëria nga aktivet mesatare (ROA) [të ardhurat neto / aktivet mesatare *100]	1.22%	1.44%	1.37%	1.41%	1.35%	1.59%
2. Rezultati neto i jashtëzakonshëm / aktivet mesatare	0.06%	0.10%	0.10%	0.10%	0.06%	0.10%
3. Shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë / të ardhurat bruto të veprimtarisë	49.46%	48.45%	47.48%	46.44%	45.37%	45.65%
4. Të ardhurat neto nga interesi / shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë	119.33%	117.91%	119.37%	125.51%	129.10%	127.75%
5. Kthyeshmëria nga kapitali aksionar mesatar (ROE) [të ardhurat neto/kapitali aksionar mesatar *100]	14.14%	18.17%	16.8%	17.0%	15.90%	21.93%
6. Aktive për punonjës [totali i aktiveve/ numri i regjistruar i punonjësve] në Lekë'000	214,633	214,238	208,380	206,806	200,190	205,312
7. Të ardhurat neto nga interesat / aktivet mesatare	3.77%	3.68%	3.68%	3.70%	3.66%	3.83%
8. Marzhi neto nga interesat:[Të ardhurat neto nga interesat / aktivet mesatare që sjellin të ardhura]	4.12%	4.24%	4.23%	4.26%	4.20%	4.51%
9. Të ardhurat nga interesat / aktivet mesatare	4.90%	5.06%	5.06%	5.08%	5.07%	5.25%
10. Shpenzime për interesa / aktive mesatare	1.36%	1.38%	1.39%	1.38%	1.40%	1.42%
11. Të ardhurat neto nga interesat / të ardhurat bruto të veprimtarisë	59.01%	57.12%	56.67%	58.28%	58.57%	58.32%
12. Të ardhurat neto nga veprimtaritë e tjera / aktivet mesatare	0.05%	0.05%	0.06%	0.09%	0.18%	0.04%
13. Shpenzimet jo për interesa / të ardhurat bruto të veprimtarisë	55.37%	54.64%	56.05%	54.43%	53.76%	52.00%
14. Shpenzime personeli / të ardhurat bruto të veprimtarisë	20.58%	19.65%	19.69%	20.04%	20.45%	19.88%
15. Shpenzime për provigjone / aktivet mesatare	0.27%	0.25%	0.42%	0.38%	0.43%	0.32%

Banka ka ruajtur një performancë të qëndrueshme në aspektin e rentabilitetit, duke reflektuar stabilitet operacional dhe menaxhim të kujdesshëm të aktiviteteve kryesore. Treguesit kryesorë tregojnë vazhdimësi në gjenerimin e të ardhurave, ndërkohë që kontrolli i kostove dhe niveli i provigjioneve mbeten në parametra të përshtatshëm. Në tërësi, rezultatet pasqyrojnë një aktivitet të balancuar dhe një pozicion të konsoliduar financiar.

<sup>1</sup> Treguesit e mësipërm janë llogaritur sipas kërkesave të Rregullores Nr.60, datë 29.08.2008 të Bankës së Shqipërisë (e ndryshuar). Ato janë llogaritur mbi pasqyrat financiare individuale të Bankës, dhe aty ku ka nevojë janë shprehur në bazë vjetore.

### 3. Struktura e Kapitalit Rregullator

Kapitali rregullator i Bankës në bazë të karakteristikave të tij dhe kushteve të përcaktuara në rregulloren për "Kapitalin rregullator të bankës", ndahet në dy kategori

- a) kapital i nivelit të parë
- b) kapital i nivelit të dytë

a) Kapitali i nivelit I llogaritet si shumë e kapitalit bazë të nivelit të parë dhe kapitalit shtesë të nivelit të parë, duke marrë në konsideratë zbritjet sipas kërkesave rregulatore. Elementet përbërës të tij janë:

- kapitali i paguar, i cili përbëhet nga aksionet e zakonshme, të cilat mbartin të gjitha karakteristikat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare. Kapitali i paguar përbëhet nga aksione të cilat nuk janë preferenciale dhe nuk ka kufizime mbi to;
- primet e këtyre aksioneve;
- fitimet e pashpërndara, të cilat janë të lira nga çdo detyrim i ardhshëm, përfshihen në kapitalin bazë të nivelit të parë të Bankës, vetëm me miratimin e asamblesë së përgjithshme për pjesën që parashikohet të jetë element përbërës i tij;
- fitimi ushtrimor i fundvitit;
- fitimi ushtrimor i periudhës raportuese, i cili përfshihet vetëm në rast se plotësohen kushtet e përcaktuara në rregullore;
- rezervat, të cilat përfshijnë rezervat ligjore të krijuara me vendim të asamblesë së aksionareve;
- diferencat e rivlerësimit. Kapitali i Bankës që është në valutë të huaj, vlerësohet në Lekë me kursin në periudhën raportuese, por në bilanc mbahet me vlerën fillestare (koston historike të tij), diferencat e lindura nga ky trajtim, përbëjnë pikërisht diferencat e rivlerësimit.

Si zë zbritës i kapitalit bazë të nivelit të parë janë:

- humbjet e periudhës raportuese;
- aktivet e patrupëzuara;
- pjesën e shumës së pjesëmarrjeve të drejtpërdrejta në instrumentet e kapitalit të nivelit të parë në Filiale, ku Banka ka investime të rëndësishme, duke konsideruar si pjesë të zbritshme: a) atë që tejkalon kufirin prej 10% të kapitalit bazë të nivelit të parë, për çdo investim, llogaritur ky para këtyre zbritjeve dhe b) pjesën e mbetur të investimeve të marra së bashku, që tejkalon 17.65% të kapitalit bazë të nivelit të parë pas zbritjeve.

b) Kapitali i nivelit II përbëhet nga borxh i varur, i cili plotëson kushtet për t'u përfshirë në kapitalin e nivelit të dytë. Borxhi i varur është emetuar nga Banka dhe është plotësisht i paguar.

Më poshtë po japim një tabelë përlllogaritëse të kapitalit rregullator të Bankës për Mars 2026 dhe Dhjetor 2025:

	Mars 2026	Dhjetor 2025
<b>Kapitali Rregullator</b>	<b>11,624,589</b>	<b>11,677,382</b>
<b>Kapitali i Nivelit të Parë</b>	<b>10,066,166</b>	<b>10,061,147</b>
<b>Kapitali Bazë i Nivelit të Parë</b>	<b>10,066,166</b>	<b>10,061,147</b>
Instrumenta të kapitalit të njohura si Kapital Bazë i Nivelit I (KBN1)	4,059,412	4,059,412
Kapitali i paguar	3,883,812	3,883,812
Primet e aksioneve	175,600	175,600
Fitimet e pashpërndara	6,162,804	6,162,804
Fitimet e pashpërndara dhe humbjet e mbartura nga periudhat e mëparshme	4,544,621	4,544,621
Fitimi ushtrimor i fundit të vitit	1,618,183	1,618,183
Fitimi ushtrimor i periudhës raportuese	-	-
Rezervat (përveç rezervave të rivlerësimit)	1,153,027	1,153,027
Diferenca rivlerësimi kreditore	(948,040)	(924,064)
(-) Aktive të tjera të patrupëzuara	(361,036)	(390,031)
(-) Instrumenta të KBN1 të subjekteve të sektorit fin. ku banka ka investimeve të rëndësishme	-	-
(-) Shuma që tejkalon kufirin prej 17.65%	-	-
<b>Kapitali Shtesë i Nivelit të Parë</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Kapitali i Nivelit të Dytë</b>	<b>1,558,423</b>	<b>1,616,235</b>
Instrumenta të kapitalit të paguara plotësisht dhe borxhi i varur	1,558,423	1,616,235

Kapitali bazë i nivelit të parë duhet të jetë në çdo kohë më i madh se niveli i kapitalit minimal të kërkuar.

#### 4. Mjaftueshmëria e Kapitalit

Kapitali rregullator duhet në çdo kohë të mbulojë kërkesën për kapital të nevojshëm për mbulimin e rrezikut të kredisë, të mbulimit të rrezikut të tregut dhe të mbulimit të rrezikut operacional.

Mjaftueshmëria e kapitalit llogaritet si raport ndërmjet shumës së kapitalit rregullator me shumën e ekspozimeve të ponderuara me rrezikun, shprehur kjo në përqindje, në zbatim të plotë të rregulloreve në fuqi.

Mbështetur në rregulloren e Bankës së Shqipërisë për "Raportin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit", Nr. 48, datë 31.07.2013, Banka përlllogarit raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit si:

Në Mijë Lekë	31 Mars 2026	31 Dhjetor 2025
1. Kapitali rregullator	11,624,589	11,677,382
2. Totali i ekspozimeve të ponderuara me rrezik	68,273,916	64,691,100
3. Kapitali bazë i nivelit të parë/ Ekspozimet e ponderuara në rrezik	$\geq 4.5\%$ 14.74 %	15.55 %
4. Kapitali i nivelit të parë/ Ekspozimet e ponderuara në rrezik	$\geq 6.0\%$ 14.74 %	15.55 %
5. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (RMK)	$\geq 12\%$ 17.03 %	18.05 %

Ekspozimet e ponderuara me rrezikun llogariten si shumë e elementeve të mëposhtëm:

- zërave të ekspozimeve dhe ekspozimeve të mundshme, të ponderuar me rrezikun e kredisë dhe rrezikun e kundërpartisë, të llogaritura sipas Metodës Standarde të rregullores së Mjaftueshmërisë së Kapitalit, duke përjashtuar ekspozimet e ponderuara me rrezikun e librit të tregtueshëm të bankës;
- kërkesës për kapital për rrezikun e tregut, të llogaritur sipas kërkesave të rregullores së Mjaftueshmërisë së Kapitalit, të shumëzuara me 12.5;
- kërkesës për kapital për rrezikun operacional, të llogaritur sipas Metodës së treguesit të thjeshtë, të përcaktuar në rregulloren e Mjaftueshmërisë së Kapitalit, të shumëzuara me 12.5

Më poshtë po japim këtë përlllogaritje:

	31 Mars 2026	31 Dhjetor 2025
Shuma e ekspozimeve të ponderuara me rrezik për rrezikun e kredisë	59,119,675	55,541,957
Shuma e ekspozimeve të ponderuara me rrezik për rreziqet e tregut	-	-
Shuma e ekspozimit të ponderuar me rrezik për rrezikun operacional	9,154,241	9,149,143
<b>Totali i ekspozimeve të ponderuar me rrezik</b>	<b>68,273,916</b>	<b>64,691,100</b>

Banka llogarit dhe përmbush edhe kërkesat e kapitalit sipas udhëzimit "Për procesin e vlerësimit të brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit" i miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë. Gjithashtu, Banka zbaton kërkesat e rregullores "Për shtesat makroprudenciale të kapitalit", miratuar me vendimin nr. 41, datë 5.6.2019 të Këshillit Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë. Bazuar në kërkesat e kësaj rregullore dhe në përputhje me vendimet përkatëse të Guvernatorit, Banka ka siguruar kapital të mjaftueshëm për të përmbushur shtesat makroprudenciale të kapitalit të cilat për dhjetor 2025 janë në masën 3% (për vitin 2025: 3%).

Në zbatim të rregullores për Procesin e Vlerësimit të Brendshëm të Nevojës për Kapital (PVBMK) norma e synuar e mjaftueshmërisë së kapitalit të Bankës për vitin 2026 është 13.08% (për vitin 2025: 12.95%). Theksojmë se përgjatë këtij procesi, Banka vlerëson një gamë më të gjerë rreziqesh, përfshi edhe rrezikun strategjik, atë reputacional, atë të të ardhurave, si dhe rrezikun e kapitalit, për të cilët vlerësohet nëse Banka është e ekspozuar dhe nëse ka nevojë për kapital shtesë.

**Rreziku i kredisë: Informacion për portofolin e kredisë sipas metodës standarde**

Për llogaritjen e shumave të ekspozimeve të ponderuar me rrezik për mbulimin e rrezikut të kredisë, Banka përdor metodën standarde të rregullores së Bankës së Shqipërisë për "Raportin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit". Bazuar në këtë rregullore, të gjitha ekspozimet dhe ekspozimet e mundshme të Bankës grupohen nëpër klasa të ekspozimeve dhe në varësi të rrezikut të grupeve më të vogla brenda secilës klasë të ekspozimit, këto ekspozime dhe ekspozime të mundshme shpërndahen nëpër klasa rreziku të vlefshme për ponderimet e përcaktuara po në këtë rregullore.

Brenda klasave të ekspozimeve, aty ku është e vlefshme, Banka përdor vlerësimet e ECAI-ve për të përcaktuar përqindjen e rrezikut të ekspozimeve të ndryshme. ECAI-të, vlerësimet e të cilave Banka përdor për këtë vlerësim të rrezikut janë Moody's, Fitch dhe S&P.

Në këtë përlllogaritje nuk përfshihen ekspozimet që janë zbritur në kapitalin rregullator të Bankës. Aty ku ekspozimet në investimet në shoqëri në sektorin financiar, nuk kalojnë kufijtë për të cilat aplikohet zbritje në kapitalin rregullator të Bankës, këto ekspozime përfshihen në klasën e ekspozimeve "Të kapitalit" dhe ponderohen me një peshë rreziku prej 250%.

**Teknikat e zbutjes së rrezikut të kredisë**

Bazuar në rregulloren për "Raportin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit", Banka përdor si teknika të zbutjes së rrezikut mbrojtjen e financuar dhe të pafinancuar të kredisë. Në mbrojtjen e financuar, për qëllime të përdorimit të *cash-collateral* si teknikë zbutjeje, Banka përdor metodën gjithëpërfshirëse për kolateralin financiar. Në bazë të kësaj metode, vlera e rregulluar e kolateralit financiar në fund të Mars 2026 është 2,910,472 Mijë Lekë (Dhjetor 2025: 3,049,753 Mijë Lekë). Si teknikë të mbrojtjes së pafinancuar të kredisë, Banka përdor mënyrën e zëvendësimit të ekspozimit ndaj klientëve, me atë ndaj Qeverisë qendrore dhe ndaj Bankave shumëpalëshe të zhvillimit, për shumën e kredive të garantuara nga palët respektive. Vlera e ekspozimit të zëvendësuar nga garancitë e marra në fund të Mars 2026 është 2,532,048 Mijë Lekë (Dhjetor 2025: 2,368,574 Mijë Lekë).

Tabela më poshtë jep informacion mbi ekspozime të ndryshme sipas peshave të rrezikut, para aplikimit të koeficientëve përkatës për ponderimin e secilës peshë rreziku:

Peshat e rrezikut	Ekspozimi para faktorëve të konvertimit	Vlera e ekspozimit e rregulluar plotësisht (E)	Vlera e ekspozimit pas faktorëve të konvertimit dhe teknikave zbutëse
0%	42,886,513	45,418,561	45,418,561
10%	-	-	-
20%	9,861,343	9,861,343	9,861,343
35%	4,122,037	4,119,526	4,119,526
50%	2,602,707	2,551,835	2,519,124
75%	23,844,183	21,522,839	20,785,378
85%	2,794,372	2,794,011	2,794,011
100%	32,368,149	29,570,278	28,324,846
125%	4,000,136	3,824,879	3,655,168
150%	2,714,641	2,620,336	2,332,236
200%	66,676	66,676	66,676
250%	792,955	792,955	792,955

**Rreziku i kundërpartisë**

Rreziku i kredisë së kundërpartisë është rreziku i dështimit të një kundërpattie në një transaksion, para se të bëhet pagesa finale e flukseve të parasë së transaksionit. Ekspozimet e Bankës ndaj kundërpalëve menaxhohen me limite specifike të miratuar për secilën kundërpalë dhe trajtohen në përputhje me kërkesat e kreut III - Rreziku i kredisë, të rregullores "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit".

Banka Union në përgjithësi ka qasje konservatore duke qenë ndjeshëm nën ekspozimet maksimale të mundshme.

**Banka Union**
*Raportet Financiare Periodike, Mars 2026*
*(shifrat në Mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)*

Tabela më poshtë jep shpërndarjen e ekspozimeve dhe ekspozimeve të mundshme të Bankës sipas klasave të ekspozimeve dhe peshës së rrezikut, kjo e fundit bazuar në vlerësimin e ECAI-ve apo plotësimin të kushteve rregullatore për secilën klasë ekspozimi.

Klasat e ekspozimeve	Vlerësimet nga:	Peshat e rrezikut											
		0%	10%	20%	35%	50%	75%	85%	100%	125%	150%	200%	250%
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive qendrore ose bankave qendrore	Nuk ka	4,433	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	ECAI	38,148,376	-	631,642	-	583,266	-	-	1,767,257	-	-	-	-
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive rajonale ose autoriteteve lokale	ECAI	-	-	84,565	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organeve administrative dhe Ojif-ve	Nuk ka	1,852,883	-	-	-	-	-	-	182	-	240	-	-
	ECAI	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj bankave shumëpalëshe të zhvillimit	Nuk ka	674,731	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
	ECAI	1,198,975	-	98,086	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organizatave ndërkombëtare	ECAI	383,319	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj institucioneve të mbikëqyrura	Nuk ka	-	-	-	-	-	-	-	3,970,566	-	48	-	-
	ECAI	-	-	8,703,601	-	553,975	-	-	164,577	-	-	-	-
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj shoqërive tregtare (korporatave)	Nuk ka	-	-	-	-	-	-	-	18,865,122	-	1,309,711	-	-
	ECAI	-	-	123,158	-	396,390	-	-	757,222	-	-	-	-
Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj portofoleve me pakicë (retail)	Nuk ka	-	-	-	-	-	20,554,520	-	-	3,528,601	-	-	-
Ekspozime ose ekspozime të mundshme të siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme	Nuk ka	-	-	-	4,119,526	985,493	230,858	2,794,011	541,188	126,567	83,007	-	-
Ekspozime (kredi) me probleme	Nuk ka	-	-	-	-	-	-	-	928,201	-	193,845	-	-
Ekspozime ndaj kategorive të klasifikuara me rrezik të lartë	Nuk ka	-	-	-	-	-	-	-	-	-	745,384	66,676	-
Ekspozime të kapitalit	Nuk ka	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	792,955
Zëra të tjerë	Nuk ka	3,155,844	-	220,290	-	-	-	-	1,330,531	-	-	-	-

**Titullizimi**

Jo e aplikueshme (N/A)

**Rreziku i Tregut**

Banka ekspozohet ndaj rreziqeve të tregut sa herë që vlera e tregut ose flukset e ardhme të parasë të një instrumenti financiar luhet si pasojë e ndryshimeve në çmimet e tregut. Rreziqet e tregut trajtohen nga Politika e Menaxhimit të Aktiv Pasivit, e cila përcakton kuadrin, përgjegjësitë dhe limitet/metodat e matjes dhe menaxhimit të këtyre rreziqeve. Politika aprovohet nga Këshilli Drejtues i Bankës dhe rishikohet të paktën një herë në vit. Ndërkohë, KAAP monitoron në mënyrë mujore këto rreziqe dhe merr masat/vendimet përkatëse në këtë kuadër.

Kërkesa për kapital për rrezikun e tregut llogaritet bazuar në kërkesat e kreut VII-Rreziku i tregut, në rregulloren "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit". Banka llogarit kërkesën për kapital për rrezikun e tregut si shumë të komponentëve të mëposhtëm:

- a) Kërkesa për kapital për aktivitetin në librin e tregtueshëm (vetëm nëse plotësohen kriteret e përcaktuara në rregullore), e cila përfshin:
  - i. Kërkesën për kapital për rreziqet e pozicionit;
  - ii. Kërkesën për kapital për rrezikun e përqëndrimit.
- b) Kërkesa për kapital rregullator për të gjitha pozicionet e bankës (pozicione në librin e tregtueshëm dhe pozicione në librat e bankës), e cila përfshin:
  - i. Kërkesën për kapital për rrezikun e kursit të këmbimit;
  - ii. Kërkesën për kapital për rrezikun e pozicioneve në mallra (commodities);
  - iii. Kërkesën për kapital për rrezikun e shlyerjes.

Lidhur me pikën a) më sipër, Banka nuk plotëson kushtet e përcaktuara në rregullore për madhësinë e librit të tregtueshëm dhe si rrjedhim llogarit kërkesën për kapital për aktivitetin në librin e tregtueshëm sipas kërkesave të kreut 3-Rreziku i kredisë. Lidhur me rrezikun e kursit të këmbimit, Banka çdo gjashtëmujor llogarit kërkesën për kapital nëse pozicioni valutor neto (total) është më i lartë se 2% e kapitalit të saj rregullator. Në këtë rast, bazuar në përcaktimet e nenit 173, kërkesa për kapital është sa 8% e madhësisë së pozicionit.

Në fund të Mars 2026 pozicioni total neto i hapur valutor është nën 2% të kapitalit rregullator, dhe për rrjedhojë nuk ka patur përlllogaritje të kërkesës për kapital për mbulimin e këtij rreziku (Dhjetor 2025: nuk ka patur kërkesë për kapital). Një tabelë përmbledhëse e ekspozimit dhe kërkesës për kapital për rreziqet e tregut në fund të Mars 2026 jepen më poshtë:

<b>Rreziqet e Tregut (000/Lekë)</b>	<b>Kërkesa për kapital</b>	<b>Ekspozimi i ponderuar me rrezik (kërkesa për kapital*12.5)</b>
Rreziqet e pozicionit	-	-
Rreziku i përqëndrimit	-	-
Rreziku i kursit të këmbimit	-	-
Rreziku i pozicioneve në mallra	-	-
Rreziku i shlyerjes	-	-
<b>Totali</b>	-	-

**Rreziku Operacional**

Për matjen e kërkesës për kapital për mbulimin e rrezikut operacional, Banka përdor metodën e treguesit të thjeshtë. Sipas kësaj metode, në fund të Mars 2026 kjo kërkesë është 732,339 Mijë Lekë. Kjo përlllogaritje bëhet çdo vit, për datën 31 Dhjetor dhe mbahet e njëjtë gjatë vitit pasardhës deri në përlllogaritjen e radhës.

**Ekspozimet në instrumente të kapitalit: informacion mbi pozicionet e përfshira në librin e bankës**

Jo e aplikueshme (N/A)

## **5. Informacion i Përgjithshëm për Ekspozimin ndaj Rreziqeve dhe Administrimin e Tyre**

### **Rreziqet dhe kuadri i administrimit të rreziqeve**

Veprimtaritë e Bankës e ekspozojnë atë ndaj një sërë rreziqesh financiare të cilat administrohen nga strukturat përkatëse brenda Bankës. Administrimi i rreziqeve përfshijnë identifikimin, analizën, vlerësimin dhe administrimin e tyre, individualisht ose kombinim. Marrja përsipër e një niveli të caktuar të rrezikut është në qendër të aktivitetit bankar ndërkohë që rreziqet operacionale janë një rrjedhojë e pashmangshme e ushtrimit të këtij aktiviteti. Në këtë kuadër, qëllimi i Bankës është arritja e një balance të përshtatshme ndërmjet rrezikut dhe kthimit, duke minimizuar efekte të mundshme negative në performancën e saj.

Për këtë qëllim Banka ka krijuar një kuadër gjithëpërfshirës për të administruar rrezikun në mënyrë efektive nëpërmjet identifikimit, matjes, kontrollit, monitorimit dhe parandalimit të ngjarjeve potenciale që mund të rezultojnë në humbje apo në zvogëlimin e potencialit të Bankës për të gjeneruar rezultate të qëndrueshme.

Mbrojtja e parë e Bankës kundër humbjeve reflektohet në kontrollet dhe modelin e brendshëm sipas të cilit Banka operon. Banka ka ndërtuar politika dhe procedura të nevojshme për administrimin e të gjitha rreziqeve me të cilët ballafaqohet. Në këtë kontekst, të gjithë proceset e biznesit janë dizenuar që të reduktojnë ndikimet e mundshme nga rreziqet, duke respektuar “oreksin” e Bankës kundrejt rrezikut dhe nivelet e përcaktuara të tolerancës ndaj tij. Çdo punonjës dhe veçanërisht “pronarët” e proceseve, mbajnë përgjegjësi primare për administrimin e rreziqeve dhe për rrjedhojë mirëmbajtja e kontrolleve të nevojshme dhe e vigjilencës në nivelin e duhur, është pjesë rutinore e punës së tyre.

Përveç sa më sipër, prej kohësh, Banka ka edhe një Departament më vete për administrimin e rrezikut, i cili shërben si një burim parësor për promovimin e kulturës së rrezikut përgjatë të gjithë linjave të biznesit të Bankës. Ky departament paraqet raporte periodike të pavarura pranë Këshillin Drejtues të Bankës, paralelisht me ato të Menaxhimit. Raportet janë gjithëpërfshirëse dhe trajtojnë dhe analizojnë të gjithë rreziqet e identifikuar. Ky funksion përfaqësohet edhe në komitete të ndryshme që ka krijuar Banka të tilla si Komiteti i Menaxhimit të Aktiv-Pasivit, Komitetin e Rrezikut Operacional dhe Rreziqet e Tjera, Komitetin e Administrimit të Rrezikut të Kredisë si edhe në Komitetin e Menaxhimit të Kapitalit dhe Performancës, duke shprehur opinionet e pavarura në fushat respektive. Ky departament ka një bashkëpunim të shpeshtë dhe të ngushtë me të gjitha njësitë e biznesit dhe nivelin Ekzekutiv dhe zhvillon procese dhe kontrolle efektive të matjes dhe administrimit të rreziqeve, shoqëruar me raportet përkatëse.

Siç është specifikuar në seksionin 1.3.1 më sipër, dhe detajuar edhe më poshtë, Banka ka edhe një sërë komitetesh, një pjesë e mirë e të cilëve kanë në fokus rreziqet ndaj të cilëve Banka është e ekspozuar gjatë kryerjes së aktivitetit të saj.

Duke konsideruar profilin e rrezikut dhe karakteristikat e tij, rreziqet me të cilët përballet Banka janë: Rreziku i Kredisë, Rreziku i Likuiditetit, Rreziku i Normave të Interesit, Rreziku i Kundërpartisë, Rreziku i Kurseve të Këmbimit dhe Rreziku Operacional, ku përfshihet rreziku Ligjor, i Përputhshmërisë dhe ai Kibernetik.

Politikat e Bankës për administrimin e rrezikut janë hartuar me qëllim identifikimin dhe analizimin e këtyre rreziqeve, përcaktimin e kontrolleve dhe limiteve të përshtatshme sipas kategorive të rrezikut, si dhe monitorimin, menaxhimin dhe raportimin e tyre, përfshi respektimin e limiteve, nëpërmjet sistemeve të besueshme dhe të përditësuara të informacionit.

### **Politikat kryesore të administrimit të rreziqeve**

#### **Politika e Kredisë**

Politika e Kredisë është dokumenti primar që përcakton parimet e administrimit të rrezikut të kredisë. Rreziku i Kredisë mund të ulet ose zbutet nëpërmjet huadhënies të orientuara drejt fluksit të parave, kolateral të mjaftueshëm si mbrojtje e nivelit të dytë, çmimit të përshtatshëm të bazuar në rrezik, strukturim efektiv dhe diversifikim të portofolit, si dhe kontrolleve të nevojshme dhe gjithëpërfshirëse të Bankës. Një pjesë shumë e rëndësishme e këtij procesi është edhe monitorimi i vazhdueshëm e i nevojshëm i fondeve rezervë për mbulimin e rrezikut (provigjioneve).

## **Politika e Administrimit të Aktiveve dhe Pasiveve (“AAP”)**

Politika e AAP është dokumenti kryesor që drejton apo udhëheq aktivitetin e Bankës në lidhje me administrimin e Aktiveve dhe Pasiveve, duke përfshirë të gjitha transaksionet me fondet, investimet e burimeve likuide dhe administrimin e rrezikut në pasqyrën e bilancit. Paragrafët e mëposhtëm përshkruajnë shkurtimisht fushat kryesore që adresohen nga Politika e AAP:

- **Administrimi i Rrezikut të Likuiditetit:**

Banka synon të mbajë një bazë depozituesish të mirë-diversifikuar dhe të sigurojë akses të përshtatshëm me alternativa të ndryshme për tërheqjen e fondeve duke administruar përqendrimit e mëdha dhe disbalancat strukturore. Përpos kësaj, Banka monitoron çdo faktor të brendshëm apo të jashtëm që mund të ketë ndikim në kapacitetin e saj për të qëndruar likuide. Politika AAP e Bankës ka zhvilluar modele sasiore për optimizimin e nivelit të parasë dhe aktiveve të tjera likuide të bankës, por në të njëjtën kohë duke respektuar edhe indikatorët e rrezikut të likuiditetit të përcaktuar nga Rregullatorët si dhe nga Këshilli Drejtues.

- **Administrimi i Rrezikut të Normës së Interesit:**

Rreziku i normës së interesit përkufizohet si ndjeshmëria e fitimeve të Bankës dhe kapitalit aksionar ndaj luhatjeve të normave të interesit. Rreziku i normës së interesit vjen si rezultat i mënyrës dhe shkallës së ndryshme me të cilën luhatja e normës së interesit ndikon tek aktivet dhe pasivet e Bankës si dhe elementët jashtë bilancit. Politika AAP të Bankës ka ndërtuar limite kontrolli të rrezikut, të cilat monitorohen vazhdimisht. Administrimi i rrezikut të normës së interesit përmblendh analiza «hendek» të ndryshimeve të aktiveve dhe pasiveve në lidhje me intervalet kohore të maturitetit, administrim të marzhit të interesit, vendosje dinamike të çmimeve në lidhje me ndjeshmërinë e aktive/pasiveve ndaj luhatjes së normës së interesit duke treguar kujdes ndaj pritshmërisë së tregjeve dhe gjithmonë duke mbetur brenda limiteve të përcaktuara.

- **Administrimi i Rrezikut të Kursit të Këmbimit:**

Rreziku i kursit të këmbimit vjen si rezultat i luhatjeve të kurseve të këmbimit të monedhave të huaja të cilat ndikojnë në ekspozimet në aktivet, detyrimet të Bankës si dhe zërat jashtë bilancit, të cilat janë denominuar në monedha të ndryshme nga Leku. Politika AAP përfshin rregulla, procedura, instrumente dhe mekanizma kontrolli, të cilat kanë për qëllim administrimin dhe zbutjen e rrezikut të kursit të këmbimit. Ky rrezik administrohet duke kontrolluar si këmbimin valutor ashtu edhe limitet e pozicioneve të hapura një-ditore duke qëndruar tërësisht në përputhje me përcaktimet dhe përkufizimet rregulatore.

## **Politika e Investimeve**

Politika e Investimeve dhe dokumentet që rrjedhin prej saj si Politika e Administrimit të Portofoleve të Letrave me Vlerë së bashku me Udhëzimin për Administrimin e Rrezikut të Portofoleve të Letrave me Vlerë, përcaktojnë bazat dhe kriteret primare për të administruar në mënyrë të përgjegjshme investimet financiare të Bankës, në përputhje me strategjinë e saj të biznesit. Kjo politikë përcakton kriteret e investimeve të mundshme, limitet si dhe elementët përkatës të rrezikut, të cilët konsiderohen si rreziqe potenciale nga këto investime, etj.

## **Politika e Rrezikut të Kundërpasive**

Rreziku ndaj ekspozimit të kundërpasive trajtohet në mënyrë shumë të ngjashme me rrezikun e kredisë dhe vlerësohet në mënyrë specifike ndaj bankave të tjera si dhe institucioneve financiare. Në këto raste, kredibiliteti i kundërpasivës dhe limitet përkatëse vlerësohen duke u bazuar në kriteret dhe metodologji të parapërcaktuara.

## **Politika për Transaksionet me Tituj dhe Shërbimet e ruajtjes dhe administrimit të instrumenteve financiare në emër të klientëve**

Kjo politikë synon të sigurojë udhëzime dhe të përcaktojë rregullat ose kërkesat për palët e përfshira në veprimtarinë e transaksioneve me tituj dhe të ndërmjetësimit për llogari të klientit, në mënyrë që të sigurojë nivelin e duhur të mbrojtjes së klientit dhe ekzekutimin sa më mirë të transaksioneve për klientët e Bankës. Qëllimi i politikës është të lehtësojë përdorimin dhe shpërndarjen efikase të likuiditetit në dispozicion, të maksimalizojë fitimin nga ofrimi i shërbimeve investuese me tituj për llogari të klientëve, të përbushë kërkesat / nevojat e investimeve të klientëve, të stimulojë aktivitetin e tregtimit të titujve dhe të adresojë

kryesisht kërkesat / nevojat e investimeve që këta klientë kanë. Në këtë kontekst, Politika siguron një kuadër të përgjithshëm rregullues për një qasje të kujdesshme ndaj shërbimeve të investimit dhe atyre ndihmëse lidhur me titujt për llogari të klientëve dhe përmbushjes së objektivave të menaxhimit dhe qëllimeve të Bankës.

### **Politika e Rrezikut Operacional**

Rreziku Operacional (“RO”) lind gjatë kryerjes dhe shpërndarjes së të gjitha produkteve dhe shërbimeve të Bankës e në të njëjtën kohë për shkak të procesimit të të gjitha transaksioneve ditore. Ai mund të vijë gjithashtu edhe si rezultat i pamjaftueshmërisë apo pasaktësisë së të dhënave nga sistemi i informacionit, dështimit apo mosfunksionimit të teknologjisë, shkeljes apo mosrespektimit të procedurave të kontrollit, si dhe mashtrimeve apo katastrofave të paparashikuara.

Kuadri rregullator i administrimit të RO së Bankës përkufizon në mënyrë shumë të qartë RO për të gjithë organizatën, si dhe filozofinë e menaxhimit, procesin e vetëvlerësimit dhe raportimit. Po ashtu, ai përfshin raportim aktiv dhe monitorim të performancës së indikatorëve kyç të rrezikut, analiza të kujdesshme të shkaqeve të humbjeve të mundshme, reagim proaktiv ndaj incidenteve si dhe mirëmbajtje dhe përditësim të programeve të vazhdimësisë së biznesit.

Në kuadër të administrimit të Rrezikut Operacional, Banka ka miratuar dhe zbaton një sërë politikash dhe procedurash specifike, ndër të cilat përfshihen politika për parandalimin dhe administrimin e mashtrimit, administrimin e shërbimeve të kontraktuara nga palë të treta (outsourcing), vazhdimësinë e biznesit, sigurinë e informacionit dhe administrimin e incidenteve operacionale. Këto dokumente mbështesin kuadrin e përgjithshëm të administrimit të RO dhe synojnë forcimin e kontroleve, reduktimin e ekspozimit ndaj humbjeve operacionale dhe rritjen e qëndrueshmërisë operacionale të Bankës.

### **Politika e Përputhshmërisë**

Politika e Përputhshmërisë përfaqëson angazhimin institucional të Bankës për të zhvilluar aktivitetin e saj në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator të jashtëm, por edhe standardet e brendshme të Bankës. Ajo përcakton parimet bazë mbi të cilat strukturohet funksionimi i Përputhshmërisë, përfshirë identifikimin, vlerësimin, menaxhimin dhe raportimin e rreziqeve që mund të lindin nga mosrespektimi i kuadrit rregullator në fuqi.

Kjo politikë përcakton rolin dhe përgjegjësitë e Njësive të Përputhshmërisë, e cila këshillon dhe mbikëqyr në lidhje me respektimin e rregulloreve dhe legjisllacionit përkatës, në bashkëpunim me funksionet ligjore, si dhe mbulon çështje që lidhen me menaxhimin e konfliktit të interesit, mbrojtjen e të drejtave të klientëve në lidhje me transparencën në produktet dhe shërbimet bankare, si dhe mbrojtjen reputacionit dhe stabilitetit afatgjatë të Bankës.

Përputhshmëria si një element i sistemit të qeverisjes së brendshme të Bankës është pjesë e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe vepron si linjë e dytë e mbrojtjes.. Në këtë kuadër, funksioni i përputhshmërisë në Bankë është i pavarur nga njësitet operacionale dhe vepron në bazë të një kornize të brendshme rregullatore, që shërben për të identifikuar, monitoruar dhe adresuar rreziqet e përputhshmërisë në mënyrë efektive.

### **Komitetet e administrimit të Rreziqeve<sup>2</sup>**

#### *Komiteti i Administrimit të Aktiv-Pasivit (“KAAP”)*

Organizimi dhe mënyra e funksionimit të KAAP mbështetet në rregulloren e brendshme të KAAP dhe në Politikën AAP. Çështjet kryesore që trajtohen nga ky komitet janë: rreziku i normës së interesit dhe ai i likuiditetit, analiza e marzheve, analiza e rezultateve financiare të Bankës, ecuria e depozitave dhe investimeve, analiza e tregjeve dhe konkurrentëve, vlerësimi i mundësive të reja të biznesi, etj. Në mënyrë më të detajuar këto janë trajtuar në Politikën AAP të Bankës.

Çështjet kryesore që ndiqen dhe analizohen në KAAP janë:

- Zhvillimet kombëtare dhe ndërkombëtare të tregjeve financiare, zhvillimet rregullatore, parashikimet për normat e interesit dhe ecurinë e tregjeve, etj;

---

<sup>2</sup> Përbërja e komiteteve është dhënë më sipër në seksionin 1.3.1

- Ecuria e fondeve, analiza e normave të interesit, struktura e aktiveve dhe portofoli i investimeve/ tregtimit apo ndonjë mospërputhje në bilancin e Bankës dhe rreziqet që mund të vijnë prej tij;
- Situata aktuale dhe e pritshme e likuiditetit;
- Mjaftueshmëria e Kapitalit, edhe në kuadër të kërkesave të ICAAP dhe SHKOMAK;
- Ecuria e rezultateve të Bankës, analiza e pasqyrave financiare dhe e treguesve kryesore;
- Strategjia e investimeve në aktive financiare jo-kredi, në përputhje me strategjinë e përgjithshme të Bankës;
- Strategjia dhe procedurat e veprimtarisë së tregtimit, ndërmjetësimit dhe kujdestarisë së letrave me vlerë (titujve) të transferueshëm me klientët e Bankës;
- Përcaktimi i politikave të çmimit dhe të tregtimit të instrumenteve financiare (*FX*, Letra me Vlerë etj.) dhe paraqitja e tyre për aprovim në Këshillin Drejtues. Si dhe miratimi i rregulloreve që lidhen me ndërmjetësimin/ tregtimin e instrumenteve financiare dhe shërbimeve mbështetëse të tyre;
- Analiza e ecurisë së veprimtarisë së tregtimit të letrave me vlerë;
- Aprovimin e normave të interesit për produktet e depozitave; blerjeve të letrave me vlerë të huaja; marrëdhënieve të reja për veprimet *FW* të këmbimit;
- Rendimenti dhe kosto e fondeve si dhe *spread*-i dhe *NIM*, në këtë kuadër;
  - a) Analiza e sensitivitetit të rrezikut të normës së interesit;
  - b) Koordinim të çmimit të produkteve me qëllim ruajtjen e *margins*.
- Ecuria e *FX* dhe aprovim të limiteve me zyrat e këmbimit;
- Përputhshmëri të veprimtarisë në përputhje me kërkesat/ndryshimet rregullatore;
- Rishikim të Politikave duke reflektuar në to ndryshimet/përmirësimet e nevojshme për të mundësuar vijueshmërinë e biznesit, optimizimin strukturor të aktiveve, përfitueshmërinë nga investimet si dhe menaxhimin sa me optimal të rrezikut, etj.

Ky informacion mundëson një monitorim të detajuar dhe të vazhdueshëm të rreziqeve të lartpërmendura, që është edhe baza për vendimmarrjen e KAAP.

Ky komitet si rregull mbledhet një herë në muaj (referohu edhe komenteve në faqen 7).

#### *Komiteti i Rrezikut Operacional dhe Rreziqet e Tjera ("KRORT")*

KRORT monitoron në mënyrë periodike ngjarjet e humbjeve operationale dhe ka përcaktuar përgjegjësitë për pakësimin e humbjeve dhe paraqitjen e zgjidhjeve të përshtatshme për zbutjen e rrezikut për aktivitetet që janë subjekt i rrezikut operacional. Ky komitet mbledhet sipas nevojave por si rregull, jo më pak se një herë në tre muaj duke vlerësuar ecurinë e rreziqeve operationale të identifikuar dhe analizën e treguesve krahasuar me limitet e vendosura nga politika përkatëse. Në këtë Komitet bëhen propozime konkrete për trajnimet që lidhen me njohuritë mbi rreziqet në Bankë duke synuar njëherësh edhe në promovimin e kulturës së rrezikut. Diskutimi dhe marrja e vendimeve në lidhje me Vazhdimësinë e Biznesit të Bankës zë një vend të veçantë në mbledhjet periodike të komitetit.

Komiteti merr në shqyrtim rezultatet e vlerësimeve të rrezikut operacional me linjat e biznesit në Bankë me frekuencë vjetore.

#### *Komiteti i Kredisë ("KKr")*

Komiteti i Kredisë ka përgjegjësinë e vendimmarrjes, detajimit dhe implementimin e procedurave mbi bazë të politikës së aprovuar nga Këshilli Drejtues në fushën e kredidhënies. Ai siguron që procesi i miratimit të kredive të ndjekë procedurat/ politikat e Bankës në përputhje me kuadrin ligjor rregullator; krijon një sistem të përshtatshëm për raportimin të Këshilli Drejtues lidhur me aplikimin e politikave dhe limiteve kreditore të vendosura. Anëtarët e Komitetit të Kredisë marrin vendime individuale për kreditë e biznesit dhe të individëve bazuar në raportet e vlerësimit të rrezikut të përgatitur nga Departamentet e Rrezikut të Kredisë nën Divizionin e Kredisë.

*Komiteti i Menaxhimit të Rrezikut të Kredisë (“KMRK”)*

Ky komitet është kryesisht përgjegjës për shqyrtimin dhe vendimmarrjen mbi ekspozimet kreditore, duke siguruar që procesi i huadhënies të jetë në përputhje me tolerancën ndaj rrezikut, politikën e kredisë dhe kërkesat rregullatore KMRK përbëhet nga përfaqësues të Drejtorisë Ekzekutive, Divizionit të Kredisë, Departamentit të Menaxhimit të Rrezikut dhe të ftuar të tjerë sipas fushave të përgjegjësisë. Ky komitet luan rol kyç në zbatimin e strategjisë së menaxhimit të rrezikut të kredisë sa i përket portofolit kreditor. Komiteti siguron që procedurat e kredisë të jenë në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi si dhe me politikën e kredisë, e cila aprovohet dhe rishikohet nga Këshilli Drejtues si rregull një herë në vit. Ai shqyrton përputhshmërinë me limitet dhe monitoron treguesit dhe limitet e paralajmërimit të hershëm të vendosur nga Banka në fushën e rrezikut të kredisë.

Në këtë komitet shqyrtohen parashikimet makroekonomike dhe zhvillimet financiare në vend të cilat ndikojnë në rrezikun e kredisë si dhe rishikohen periodikisht rezultatet e stress test-eve për cilësinë e portofolit të kredisë së Bankës. KMRK ka rol të rëndësishëm në zbatimin e politikave të provigjonimit, përfshirë kategorizimin dhe kriteret bazë të provigjonimit të tyre. Rikuperimi dhe fshirja e kredive (përpara miratimit përfundimtar nga Këshilli Drejtues) janë një pjesë e rëndësishme e fushës së punës së këtij komiteti. Komiteti shqyrton në baza vjetore kërkesat e brendshme për kapital të lidhura me rrezikun e kredisë (procesi i PVBMK) (referohu edhe komentëve në faqen 7).

*Komiteti i Menaxhimit të Kapitalit dhe Performancës (“KMKP”)*

Komiteti ka si funksion kryesor të sigurojë që planifikimi, menaxhimi dhe monitorimi i kapitalit të Bankës, si dhe treguesit e lidhur me të, të jenë në përputhje me objektivat strategjike dhe kërkesat rregullatore. Ai përbëhet nga 3 anëtarë, përfaqësues të Drejtorisë Ekzekutive, dhe RMD. Përveç tyre, disa të ftuar (anëtarë DE dhe menaxher të linjës së parë) marrin pjesë rregullisht në mbledhjet e komitetit. Ky komitet fokusohet në tre komponentë të rëndësishëm, si pjesë integrale e menaxhimit të rrezikut në bankë: menaxhimi i kapitalit, vlerësimi i planit të rimëkëmbjes dhe vlerësimi i performancës financiare të Bankës lidhur me kapitalin.

Komiteti ndihmon menaxhimin e Bankës për sigurimin e një niveli optimal të kapitalit, me një strukturë eficiente. Ai merr në konsideratë dhe monitoron kërkesat për SHKOMAK si edhe të Levës Financiare. Ky komitet merr pjesë në Procesin e Vlerësimit të Brendshëm të Mjaftueshmërisë së Kapitalit si edhe monitoron dhe analizon periodikisht nivelet e normave aktuale të paralajmërimit të Bankës përkundrejt atyre të parashikuara në PVBMK. Në kuadër të buxhetimit, ky komiteti rishikon rezultatin e RMK/SHKOMAK që del mbi bazë të skenarëve për rritjen, përbërjen e aktiveve, provigjoneve, rezultatin e pritshëm financiar të Bankës. Komiteti rishikon dhe analizon realizimin e buxhetit dhe të çdo devijimi të rezultateve financiare nga buxhetimi përse i përket impaktit që mundet të ketë mbi kapitalin e bankës si edhe marrjen e masave për përmirësimin e situatës në drejtim të realizimit të buxhetit apo kur nivelet i afrohen limiteve nën monitorim.

*Komiteti i Përputhshmërisë (“KP”)*

Roli kryesor i Komitetit të Përputhshmërisë është forcimi i kuadrit të kontrollit të brendshëm duke informuar, këshilluar, ndërmarrë veprime dhe mbështetur Bordin e Drejtorëve dhe drejtuesit e funksioneve kryesore të Bankës në lidhje me rreziqet aktuale të përputhshmërisë me të cilat përballet Banka. Ky komitet shqyrton zhvillimet kryesore rregullatore, ligjet dhe standardet dhe siguron një vlerësim të plotë të rreziqeve të përputhshmërisë, duke i integruar ato në programin vjetor të Përputhshmërisë.

**6. Borxhi i Varur**

Borxhi i Varur i Bankës është në formën e Obligacioneve dhe është emetuar si më poshtë:

- në vitin 2021, 2.0 Milionë Euro me afat shtatëvjeçar dhe normë kuponi fiks 3.30% në vit;
- në vitin 2022, 3.0 Milionë Euro me afat shtatëvjeçar dhe normë kuponi fiks 3.50% në vit;
- në vitin 2023, 3.5 Milionë Euro me afat shtatëvjeçar dhe normë kuponi fiks 4.85% në vit;
- në vitin 2024, 5.0 Milionë Euro me afat shtatëvjeçar dhe normë kuponi fiks 5.00% në vit.

Të gjitha emetimet janë aprovuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (“AMF”), si dhe janë miratuar nga Banka e Shqipërisë për njohje si pjesë e kapitalit rregullator të Bankës.

Në qershor 2025, Banka nënshkroi një marrëveshje financimi me EFSE, e cila do të përdoret si instrument i kualifikueshëm për Kapital të Nivelit II. Ky financim synon të rrisë kapacitetin huadhënës të Bankës dhe të forcojë bazën e saj kapitale. Shuma e disbursuar nën këtë linjë është 5 Milionë Euro me maturitet shtatëvjeçar dhe normë interesi variabël Euribor 6M+4% në vit. Pas miratimit nga Banka e Shqipërisë, ky borxh i varur u përfshi në kapitalin rregullator të Bankës.

	<u>31 Mars 2026</u>	<u>31 Dhjetor 2025</u>
Borxhi i varur	1,776,555	1,983,785
Interesi i përllogaritur	26,006	22,808
<b>Totali</b>	<b>1,802,561</b>	<b>2,006,593</b>

## 7. Rreziku i Kredisë

### Struktura e administrimit të rrezikut të kredisë

Rreziku i kredisë është rreziku që pala tjetër e një instrumenti financiar të dështojë në përmbushjen e detyrimeve të saj kontraktuale, duke i shkaktuar Bankës humbje. Banka ekspozohet ndaj këtij rreziku nëpërmjet veprimtarisë së saj kredituese, si dhe në rastet kur ajo vepron si ndërmjetëse në emër të klientëve ose palëve të treta, përfshi edhe lëshimin e garancive.

Banka administron dhe kontrollon rrezikun e kredisë duke përcaktuar limite për nivelin e rrezikut që është e gatshme të pranojë për palët individuale dhe në grup/total, përqendrimet gjeografike dhe të industrisë dhe duke monitoruar ekspozimet në lidhje me këto kufizime. Limitet kreditore të lejuara për një klient bazohen kryesisht nga profili individual i rrezikut të tij dhe rankimit të tij kreditor bazuar në kriteret e njohura të kreditimit.

Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë administrohet gjithashtu nëpërmjet marrjes së kolateraleve dhe garancive, të tilla si prona hipotekare ose rezidenciale, pengje mbi aktivet dhe inventarët e bizneseve, depozita dhe llogari të vendosura në bankë (kolateral në mjete monetare) dhe garanci personale për kredinë. Në linjë me zhvillimet në treg, Banka ofron edhe kredi konsumatore apo kredi biznesi të vogla të pasiguruara me kolateral financiar apo pasuri hipotekore, rreziku për të cilat adresohet edhe nëpërmjet strategjisë së axhustimit të çmimit (risk-adjusted-price).

Në përputhje me politikën e aprovuar nga Këshilli Drejtues, Komiteti i Kredisë (KK) dhe Komiteti i Menaxhimit të Rrezikut të Kredisë (KMRK) kanë përgjegjësinë kryesore për menaxhimin e rrezikut të kredisë. KMRK luan një rol kyç në zbatimin e strategjisë së menaxhimit të rrezikut të kredisë sa i përket portofolit kreditor. Ky komitet siguron që procedurat e kredisë janë në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi si dhe politikën e kredisë, politikën e cila aprovohet dhe rishikohet nga Këshilli Drejtues si rregull një herë në vit. Ai shqyrton përputhshmërinë me limitet dhe monitoron treguesit dhe limitet e paralajmërimit të hershëm të vendosur nga Banka në fushën e rrezikut të kredisë.

Gjithashtu, KMRK rishikon periodikisht rezultatet e stress test-eve dhe ka rol në implementimin e politikave të provigjionimit, përfshirë kategorizimin dhe kriteret përkatëse. Rikuperimi dhe fshirja e kredive, para miratimit përfundimtar nga Këshilli Drejtues, janë pjesë e përgjegjësisë të këtij komiteti.

Në trajtimin e rrezikut të kredisë, ndarja e përgjegjësisë në fushën e administrimit të rrezikut, organizohet si në vijim:

- Divizioni i Kredisë – është përgjegjës për vlerësimin e rrezikut në procesin e kredihënies, si për klientët individë ashtu dhe për jo-individët. Në strukturën e këtij divizioni përfshihen strukturat përgjegjëse për vlerësimin e rrezikut të kredisë, vlerësimin e kolateraleve, monitorimin/ndjekjen e kredive në vonesë, përllogaritjen e provigjioneve sipas standardit lokal (BoA), etj.
- Departamenti i Menaxhimit të Rrezikut – nëpërmjet Njësisë së Rrezikut dhe Kontrollit të Kredive, është përgjegjës për: menaxhimin e rrezikut të kredisë në nivel portofoli, përgatitjen e raporteve dhe analizave specifike, kryerjen e stress testeve, përllogaritjen e provigjioneve sipas standardit IFRS dhe kontrollin e provigjioneve të përllogaritura nga Departamenti i Menaxhimit të Portofolit të Kredive, çështjet që lidhen me kapitalin rregullator (dhe mjaftueshmërinë e kapitalit), etj.

Çdo njësi biznesi i kërkohet të zbatojë politikën dhe procedurat e kredisë në Bankë me autoritetin e aprovimit të kredisë të deleguar nga Divizioni i Kredisë dhe Komiteti i Kredisë. Çdo njësi biznesi është përgjegjëse për cilësinë dhe performancën e portofolit të saj të kredisë dhe për monitorimin dhe kontrollin e rreziqeve të kredisë në portofolin e saj, përfshirë dhe ato që janë subjekt i aprovimit qendror ashtu edhe atyre të decentralizuara.

Banka ka vendosur një proces të rishikimit të cilësisë kreditore i cili mundëson një identifikim të hershëm të ndryshimeve potenciale të kapacitetit pagues të kundrapalëve, përfshi edhe rishikime të rregullta të kolateraleve të tyre.

Limitet kreditore përcaktohen mbi bazë të kategorizimeve të brendshme të rrezikut, të cilat i atribuojnë çdo kundërpasë një risk të caktuar. Procesi i rishikimit të cilësisë kreditore synon të mundësojë vlerësimin e humbjeve potenciale nga ekspozimet kreditore, dhe ndërmarrjen në kohë të masave korrektuese.

Banka zbaton dhe monitoron kërkesat e rregullores “Për administrimin e rrezikut të kredisë” lidhur me fshirjen nga bilanci të kredive të humbura. Fshirja nga bilanci shqyrtohet në KMRK dhe miratohet nga Këshilli Drejtues. Si rregull, Banka aplikon fshirje të ekspozimit vetëm për ato ekspozime apo pjesë të tij për të cilat janë ndjekur të gjitha procedurat ligjore të rikuperimit, dhe jo më vonë se 2 vite nga klasifikimit i tyre në kategorinë “të humbura”. Pavarësisht fshirjes nga bilanci, Banka vazhdon të monitorojë dhe të ndjekë në mënyrë aktive procesin e rikuperimit të këtyre ekspozimeve nëpërmjet procedurave ligjore përkatëse.

Bazuar në politikat e aprovuara nga Këshilli Drejtues, Komiteti i Menaxhimit të Aktiv Pasiveve të Bankës është përgjegjës për menaxhimin e rrezikut të kredisë të lidhur me investimet. Përveç kësaj Departamenti i Thesarit, që raporton tek Drejtori i Përgjithshëm, dhe Departamenti i Menaxhimit të Rrezikut që raporton pranë Drejtorit të Divizionit të Financës, janë përgjegjës për monitorimin e rrezikut të kredisë që lidhet me investimet në tituj dhe tregun e parave të Bankës.

### **Kategorizimi i kredive në kuadër të rrezikut të kredisë**

Banka ka krijuar procedurat përkatëse për administrimin e rrezikut të kredisë, përshtatur kjo me vëllimin, kompleksitetin e veprimtarisë së saj, por gjithmonë duke u bazuar në rregulloren nr. 62 të Bankës së Shqipërisë "Për Administrimin e rrezikut të kredisë".

Mbështetur në këtë rregullore, Banka klasifikon kreditë në bazë të ditëvonesave në shlyerjen e kredisë dhe gjendjes financiare të kredimarrësit sipas kategorive të mëposhtme:

- a) standarde;
- b) në ndjekje;
- c) nënstandarde;
- d) të dyshimta;
- e) të humbura

Banka për persona apo grup personash të lidhur me njëri-tjetrin, për të cilët është regjistruar më shumë se një ekspozim, bëjnë klasifikimin e kredive në një kategori të vetme, duke u bazuar në klasifikimin më të ulët ndërmjet klasifikimeve individuale.

### **Portofoli kreditor, kreditë me probleme dhe krijimi i fondeve rezervë**

Kreditë konsiderohen me probleme kur janë të klasifikuara në një nga tre klasat e fundit të kategorive të mësipërme. Në varësi të kategorive të mësipërme, Banka krijon fonde rezervë për mbulimin e humbjeve të mundshme nga kreditë. Fondet krijohen në përputhje me rregulloren për "Administrimin e rrezikut të kredisë", duke aplikuar normat e provigjionimit të çdo kategorie në të cilën kredia/klienti bën pjesë, si mbi principalin e mbetur dhe mbi interesin e rrjedhur për këto kredi.

Ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë administrohet gjithashtu pjesërisht nga marrja e kolateraleve dhe garancive. Llojet kryesore të kolateraleve janë:

- Prona hipotekore ose rezidenciale;
- Pengje mbi aktivet dhe inventaret e bizneseve;
- Depozita dhe llogari të vendosur në bankë (kolateral në mjete monetare);
- Garantë personale për kredinë
- Skemat e ndarjes së rrezikut kreditor (*risk sharing*).

Përveç kredive me afat dhe overdrafteve të biznesit që janë siguruar nga llojet e mësipërme të kolateralit, Banka jep gjithashtu overdrafte në llogaritë e pagës. Nuk merren pengje për këto lloj paradhëniesh për sa kohë që pagesat mujore të pagave kompensojnë pjesën e përdorur të limitit të dhënë. Garancitë financiare dhe letrat në pritje të kredisë janë të kolateralizuara me mjete monetare.

Më poshtë është kredia e dhënë klientëve, e grupuar sipas tipit të klientit:

**Banka Union**

Raportet Financiare Periodike, Mars 2026

(shifrat në Mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

	31 Mars 2026	31 Dhjetor 2025
Kredi dhënë institucioneve financiare	4,478,768	4,873,269
Kredi dhënë individëve	29,229,494	28,055,898
Kredi dhënë kompanive	31,342,690	28,686,104
<b>Totali</b>	<b>65,050,952</b>	<b>61,615,271</b>

Portofoli i mësipërm i kredisë ka një thyerje sipas maturitetit të mbetur kontraktual të tillë:

31 Mars 2026							
Produkti	Deri 1 muaj	1 - 3	3 - 6	6 - 12	1 - 5 vite	>5 vite	Totali
Kredia	359,955	81,151	211,105	1,128,461	20,544,657	35,926,034	58,251,363
Overdrafte	881,405	740,725	935,855	2,880,968	882,215	-	6,321,168
Karta Kreditsi	3,446	-	385	-	474,590	-	478,421
<b>Totali</b>	<b>1,244,806</b>	<b>821,876</b>	<b>1,147,345</b>	<b>4,009,429</b>	<b>21,901,462</b>	<b>35,926,034</b>	<b>65,050,952</b>

31 Dhjetor 2025							
Produkti	Deri 1 muaj	1 - 3	3 - 6	6 - 12	1 - 5 vite	>5 vite	Totali
Kredia	229,761	209,782	448,477	1,298,770	20,420,988	33,278,476	55,886,254
Overdrafte	211,904	550,259	1,242,979	2,026,218	1,233,929	-	5,265,289
Karta Kreditsi	2,714	-	-	170	460,844	-	463,728
<b>Totali</b>	<b>444,379</b>	<b>760,041</b>	<b>1,691,456</b>	<b>3,325,158</b>	<b>22,115,761</b>	<b>33,278,476</b>	<b>61,615,271</b>

Fondet rezervë për mbulimin e humbjeve të mundshme të kredive përlogariten çdo muaj. Në fund të Mars 2026 dhe Dhjetor 2025, këto fonde ishin krijuar për këto kategori të kredive të Bankës:

	31 Mars 2026	31 Dhjetor 2025
Hua standarde	575,659	539,903
Hua në ndjekje	90,873	111,406
Hua nënstandarde	304,092	224,724
Hua të dyshimta	763,090	847,153
Hua të humbura	880,417	819,636
<b>Totali i provigjoneve për huatë</b>	<b>2,614,131</b>	<b>2,542,822</b>

Më poshtë po japim klasifikimin e portofolit të kredisë sipas një shpërndarje gjeografike:

31 Mars 2026			
	Teprica bruto	Provigjone	Kredi me probleme
Tiranë	46,738,423	1,784,082	2,098,178
Durrës	5,044,092	141,236	118,788
Veri	4,651,133	230,120	258,494
Jug	6,225,545	331,745	518,641
Juglindje	2,391,759	126,948	127,740
<b>Totali</b>	<b>65,050,952</b>	<b>2,614,131</b>	<b>3,121,841</b>

Klasifikimi i portofolit të kredisë sipas sektoreve të ekonomisë:

31 Mars 2026			
	Teprica bruto	Provigjone	Kredi me probleme
Tregtia me shumicë dhe pakicë	8,542,374	425,895	568,042
Ndërtimi dhe pasuri të patundshme	7,484,612	371,252	483,828
Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit	8,394,603	374,743	445,937
Aktivitetet Financiare dhe të Sigurimit	5,113,261	29,775	4,786
Aktivitetet të tjera shërbimi	2,870,444	111,205	158,520
Informacioni dhe Komunikacioni	624,127	11,819	3,461
Industria nxjerrëse dhe përpunuese	4,624,279	328,680	487,433
Furnizimi me Energji Elektrike, Gaz e Avull dhe me Ajër të kondicionuar	1,638,589	18,158	4,370
Arsimi	351,937	37,661	38,942
Të tjera	4,036,756	156,084	160,320
Individë	21,369,970	748,859	766,202
<b>Totali</b>	<b>65,050,952</b>	<b>2,614,131</b>	<b>3,121,841</b>

Më poshtë po japim ndryshimet të fondet rezervë për humbjet nga kreditë gjatë periudhës:

- Huat standarde dhe në ndjekje

	31 Mars 2026	31 Dhjetor 2025
Gjendja në fillim të vitit	651,308	547,512
Provizjioni për vitin, neto	17,992	108,912
Efekti i ndryshimit të kursit të këmbimit	(2,768)	(5,116)
<b>Gjendja në fund të vitit/periudhës</b>	<b>666,532</b>	<b>651,308</b>

- Huatë me probleme

	31 Mars 2026	31 Dhjetor 2025
Gjendja në fillim të vitit	1,891,514	2,141,959
Provizjioni specifik, neto për vitin	62,408	167,914
Hua të fshira gjatë vitit	-	(401,330)
Efekti i ndryshimit të kursit të këmbimit	(6,323)	(17,029)
<b>Gjendja në fund të vitit/periudhës</b>	<b>1,947,599</b>	<b>1,891,514</b>

## 8. Rreziku i Tregut (FX +IRR)

Banka ekspozohet ndaj rreziqeve të tregut sa herë që vlera e tregut ose flukset e ardhme të parasë të një instrumenti financiar luhaten si pasojë e ndryshimeve në çmimet e tregut. Rreziqet e tregut burojnë nga pozicione të hapura të bilancit në norma interesi dhe monedha, të cilat të gjitha ekspozohen ndaj lëvizjeve të përgjithshme dhe të veçanta të tregut, dhe ndryshimeve në nivelin e volatilitetit të normave të tregut ose çmimeve si norma e interesit, marzhet e kredisë, dhe kurset e këmbimit të valutave.

Rreziqet e tregut trajtohen nga Politika e menaxhimit të Aktiv Pasivit, e cila përcakton kuadrin, përgjegjësitë dhe limitet/metodat e matjes dhe menaxhimit të këtyre rreziqeve. Është KAAP i cili monitoron në mënyrë mujore këto rreziqe dhe merr masat/vendimet përkatëse në këtë kuadër.

- **Rreziku i monedhës së huaj**

Banka është e ekspozuar ndaj rrezikut të monedhave për shkak të transaksioneve në valuta të huaja. Rreziku i monedhës së huaj përfaqëson rrezikun që vlera e instrumentit financiar të luhetet si pasojë e ndryshimeve në kursin e këmbimit, duke ndikuar në pasqyrat financiare të Bankës. Ky rrezik lind kur nga pozicionet e hapura në monedha të huaja.

Banka e administron këtë rrezik duke mbyllur në mënyrë të përditshme pozicionet e hapura valutore si dhe duke vendosur dhe monitoruar limite mbi këto pozicione, përfshirë dhe limitet stop-loss. Strukturat përgjegjëse monitorojnë pozicionin valutor dhe luhatjet e monedhës duke aplikuar limite të brendshme për pozicionet e hapura valutore sipas monedhës. Departamenti i Thesarit është përgjegjësi kryesor dhe përben linjën e parë e kontrollit për ndjekjen dhe monitorimin ditor të këtij rreziku, në përputhje me politikat përkatëse. Funkcionet e pavarura të monitorimit dhe të kontrollit të rrezikut të monedhës kryhen nga Drejtori i Divizionit të Financës dhe Departamenti i Menaxhimit të Rrezikut mbi baza ditore, si dhe në kuadër të KMAP. Ecuria kundrejt limiteve të pozicioneve valutore raportohen mbi baza mujore edhe tek KAAP, në rast tejkalimesh edhe në Këshillin Drejtues.

Banka në mënyrë konsistente është në përputhje me limitet e vendosura, të cilat janë tejet më konservatore se ato të Rregullatorit. Në çdo rast, limitet e pozicionit valutor të Bankës janë nën limitet rregullatore.

- **Rreziku i normes së interesit**

Rreziku i normës së interesit është rreziku që kapitali dhe fitimet e Bankës të ndikohen negativisht nga ndryshimi i normave të interesit të instrumenteve financiarë. Ndryshimet në normat e interesit ndikojnë si në vlerën aktuale, ashtu edhe në kohën e flukseve të pritshme monetare.

Banka monitoron dhe menaxhon këtë rrezik nëpërmjet analizës së hendekut ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve, me synim përafrimin e maturimeve dhe rikimimit të tyre. Kjo qasje synon të reduktojë ndjeshmërinë ndaj luhatjeve të normave të interesit. Funkcioni i monitorimit dhe kontrollit të këtij rreziku kryhet nëpërmjet KMAP. Politikat përkatëse përfshijnë limite të përcaktuara, metoda matjeje dhe raportime periodike që analizohen edhe rishikohen periodikisht.

## Banka Union

Raportet Financiare Periodike, Mars 2026

(shifrat në Mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

Në përputhje me kërkesat rregullatore, Banka klasifikon aktivet dhe pasivet në zëra me normë interesi fikse (forma *FIR*) dhe zëra me normë interesi të ndryshueshme (forma *VIR*).

Në vijim paraqitet pozicioni neto për monedhat kryesore si dhe ndryshimi në vlerën e ekspozimit për skenarin e lëvizjes paralele të normave të interesit prej 200 pikësh bazë për 31 Mars 2026:

Totali i pozicioneve të ponderuara	Monedha	31 Mars 2026
	Lekë	1,508,114
Pozicionet e ponderuara neto sipas monedhës - ( <i>FIR+VIR</i> )	Euro	(285,193)
	Të tjera	5,770
Ndryshimi në vlerën e ekspozimit		<b>1,228,690</b>
Kapitali Rregullator		<b>11,624,589</b>
(Ndryshimi në vlerën e ekspozimit/Kap.Rreg.)*100		<b>10.57 %</b>

Banka monitoron pozicionin total neto të ponderuar i cili nuk duhet të tejkalojë nivelin prej 20% të kapitalit rregullator të Bankës.

## 9. Rreziku i Likuiditetit

### Struktura e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Banka do të përballet me vështirësi në sigurimin e fondeve dhe për përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga instrumentet financiare, dhe për të ruajtur vazhdimësinë e veprimtarisë së saj. Në bazë operative, Banka monitoron në mënyrë të vazhdueshme pozicionin e likuiditetit. përfshi ecurinë e depozitave të klientëve të saj, si dhe ecurinë e investimeve/financimeve, duke ndërmarre veprime korrigjuese për të ruajtur nivele të përshtatshme likuiditeti në përputhje me limitet e brendshme dhe rregullatore.

Në një nivel më strategjik, Banka gjatë procesit të buxhetimit Banka harton parashikimet e flukseve hyrëse dhe dalëse si dhe të rezervave të likuiditetit. Nëpërmjet KAAP, Banka monitoron vazhdimisht ecurinë kundrejt buxhetit dhe sistemit, hendekut të likuiditetit si dhe një sërë treguesish kryesorë të likuiditetit.

Banka operon brenda limiteve të vendosura të likuiditetit dhe koordinon menaxhimin e tij në nivel degësh përmes Njesisë së Administrimit të Cash-it (Departamenti i Operacioneve), e cila monitoron në baza ditore nevojat për likuiditet dhe përputhshmërinë me limitet e vendosura.

Politikat, limitet e oreksit të rrezikut (risk appetite) si dhe strategjia e menaxhimit të likuiditetit janë subjekt i rishikimeve nga ana e KAAP dhe miratimeve vjetore respektivisht nga Këshilli Drejtues. Raportime ditore dhe periodike kryhen për të monitoruar pozicionin e likuiditetit e degëve dhe Bankës në tërësi.

Banka mbështetet kryesisht tek depozitat e klientëve si burim kryesor financimi, si dhe Repo-ve dhe huave afatshkurtra. Natyra afatshkurtër e një pjese të këtyre burimeve rrit rrezikun e likuiditetit i cili menaxhohet nëpërmjet mbajtjes së niveleve të përshtatshme të aktiveve likuide, çmimeve konkurruese, strukturimit të përshtatshëm të flukseve dhe monitorimit të vazhdueshëm të tregut.

Banka monitoron treguesit kryesorë të likuiditetit, përfshi koeficientin e aktiveve likuide ndaj detyrimet afatshkurtra, Raportin e Mbulimit me Likuiditet (RML), si dhe Raportin Neto të Financimit të Qëndrueshëm (RNFO) tregues rregullatorë në kuadër të menaxhimit të likuiditetit. Këta tregues kanë qenë vazhdimisht mbi limitet rregullatore dhe ato të brendshme. Gjatë vitit, Banka kreu dhe rishikimin vjetor të PVBML në përputhje me kërkesat e udhëzimit Nr.2 dt 12/01/2021 Procesi i Vlerësimit të Brendshëm të Mjaftueshmërisë së Likuiditetit të cilat hynë në fuqi që prej 31/12/2022.

Për të menaxhuar rrezikun e likuiditetit që vjen nga detyrimet financiare, Banka mban një portofol aktivesh likuide duke përfshirë dhe paranë fizike dhe ekuivalentët e saj (kryesisht investime në tregun e parasë dhe në tituj), për të cilat ka një treg aktiv likuid, të cilët mund të shiten në rast nevoje. Banka mban likuiditetin në një vlerë, strukturë dhe koeficientë që e lejojnë atë të përmbushë detyrimet e saj dhe angazhimet e marra sipas afateve kohore, por edhe të suportojë rritjen e buxhetuar të aktivitetit të saj, me një kosto të arsyeshme dhe rrezik në përputhje me nivelin e rrezikut të pranuar në kuadër të apetitit të rrezikut të Bankës.

Monitorimi dhe kontrolli i likuiditetit kryhet nëpërmjet KAAP, nëpërmjet një seti raportesh ditore, javore dhe mujore që përgatiten dhe analizohen. Raporti ditor i treguesit të likuiditetit, aktive likuide mbi detyrimet afatshkurtra me afat të mbetur maturimi deri në një vit, kontrollon respektivisht mbajtjen e aktiveve likuide

## Banka Union

Raportet Financiare Periodike, Mars 2026

(shifrat në Mijë Lekë, përveçse kur shprehet ndryshe)

në një nivel të mjaftueshem, nën skenarin e zakonshëm të biznesit. Raportet mujore përfshijnë një sërë koeficientësh rregullator dhe të brendshëm, analiza të hendeikut të aktiveve dhe detyrimeve me specifika të veçanta të Bankës, skenarë stresi mbi treguesit e likuiditetit, përfshirë këtu dhe identifikimin e periudhës së mbijetesës nën skenarë të ndryshëm stresi. Përgjithësisht, raportet prodhohen për çdo monedhë të rëndësishme më vete si dhe për të gjitha monedhat së bashku.

Banka ka të miratuar gjithashtu Planin e Kontigjensës së Fondeve dhe monitoron në mënyrë periodike treguesit bazë të tij, si dhe ka përfshirë këtë rrezik si një ndër elementët kyç të Planit të Rimëkëmbjes, sipas specifikimeve të rregullores përkatëse. Të dy këto dokumente rishikohen mbi baza vjetor nga KAAP dhe aprovohen nga Këshilli Drejtues.

### Koeficienti i likuiditetit

Bazuar në rregulloren nr. 71 të Bankës së Shqipërisë për "Administrimin e rrezikut të likuiditetit", Banka përlllogarit dhe monitoron koeficientët e likuiditetit (aktivet likuide/pasivet afatshkurtra) në baza javore. Ajo sigurohet që këta koeficientë të jenë mbi limitet rregullatore.

Në tabelën më poshtë po japim një ndjekje tremujore të koeficientit të likuiditetit për të gjitha monedhat së bashku, i cili gjithmonë ka qenë mbi nivelin rregullator prej 20%:

	31 Mars 2026	31 Dhjetor 2025	30 Shtator 2025	30 Qershor 2025	31 Mars 2025	31 Dhjetor 2024
Totali i Aktiveve Likuide	26,259,808	27,067,552	27,506,475	25,922,995	27,470,517	23,602,468
Totali i Pasiveve Afatshkurtra	75,449,033	75,266,669	69,721,745	70,263,231	70,528,707	65,101,201
<b>Treguesi i likuiditetit (në %)</b>	<b>34.80%</b>	<b>35.96%</b>	<b>39.45%</b>	<b>36.89%</b>	<b>38.95%</b>	<b>36.26%</b>

### Raporti i mbulimit me likuiditet (RML)

Bazuar në rregulloren e Bankës së Shqipërisë "Për Raportin e Mbulimit me Likuiditet", e cila ka hyrë në fuqi në datë 1 Mars 2020, Banka siguron në çdo kohë një raport të mbulimit me likuiditet prej të paktën 100% në total dhe të paktën 80% për totalin e monedhave të huaja të rëndësishme.

Në tabelën më poshtë po japim një ndjekje tremujore të RML për të gjitha monedhat së bashku, i cili gjithmonë ka qenë mbi nivelin rregullator:

	31 Mars 2026	31 Dhjetor 2025	30 Shtator 2025	30 Qershor 2025	31 Mars 2025	31 Dhjetor 2024
Rezerva e likuiditetit	26,029,129	27,939,186	26,638,732	25,393,890	26,205,049	24,813,113
Flukset dalëse neto	14,259,943	14,669,691	13,997,909	11,528,551	11,568,178	10,562,348
<b>RML</b>	<b>182.53%</b>	<b>190.46%</b>	<b>190.31%</b>	<b>220.27%</b>	<b>226.53%</b>	<b>234.92%</b>

### Raporti Neto i Financimit të Qëndrueshëm (NSFR)

Bazuar në rregulloren e Bankës së Shqipërisë "Për Raportin Neto të Financimit të Qëndrueshëm të Bankave", e cila ka hyrë në fuqi në datë 1 Janar 2023, Banka siguron në çdo kohë një raport neto të financimit të qëndrueshëm prej të paktën 100% për të gjitha monedhat së bashku, si edhe për totalin e monedhave të huaja të rëndësishme.

NSFR në total, rezultoi si më poshtë:

	31 Mars 2026	31 Dhjetor 2025	30 Shtator 2025	30 Qershor 2025	31 Mars 2025
Financimi i qëndrueshëm i disponueshëm	87,819,154	84,689,904	82,981,346	80,988,511	79,772,819
Financimi i qëndrueshëm i kërkuar	58,245,515	54,548,400	53,414,226	52,933,917	51,851,304
<b>NSFR</b>	<b>150.77%</b>	<b>155.3%</b>	<b>155.4%</b>	<b>153.0%</b>	<b>153.8%</b>

## 10. Rreziku Operacional

Rreziku operacional është rreziku i humbjes që rrjedh nga proceset e brendshme të papërshtatshme ose të dështuara, nga njerëzit, sistemet, ose nga ngjarje të jashtme.

Rreziku operacional është i pranishëm në të gjitha funksionet e një banke, duke përfshirë aktivitetet në degët që përballen me klientët, te proceset e brendshme të përpunimit të transaksioneve, teknologjinë dhe sistemet IT, raportimet financiare dhe përputhshmërinë me kuadrin rregullator. Ai mund të lindë nga

gabime njerëzore, dështime të sistemeve, mangësi në proceset e brendshme ose nga ngjarje të jashtme si fatkeqësi natyrore apo sulme kibernetike.

Për menaxhimin e rrezikut operacional Banka ka hartuar një kuadër të brendshëm i cili përfshin përkufizime të qarta të kontrolleve dhe përgjegjësi për menaxhimin e rrezikut operacional të organizatës, dhe një filozofi të vetë-vlerësimit të proceseve të biznesit. Gjithashtu ka zhvilluar një set treguesish kyç të rrezikut të brendshëm, krahas atyre rregullatorë, të cilët i monitoron në mënyrë aktive.

Komiteti i Rrezikut Operacional dhe Rreziqet e Tjera ("KRORT") i Bankës monitoron në mënyrë periodike ngjarjet që shkaktojnë apo mund të shkaktojnë humbje operationale, analizon shkaqet e ndodhjes së tyre dhe përcakton masa për përmirësimin në proceseve dhe praktikave ekzistuese të Bankës, me qëllim reduktimin e rrezikut dhe rritjen e efikasitetit operacional.

Përveç kësaj, Banka ka krijuar Komitetin e Përputhshmërisë, i cili mbulon kërkesat e pajtueshmërisë dhe çështjet e lidhura me to në baza periodike.

## **11. Rreziqet mjedisore, sociale dhe të qeverisjes ("ESG")**

ESG përfaqëson mundësitë për të pësuar humbje, kosto shtesë apo mosrealizim të të ardhurave të planifikuara. Faktorët aktualë ose të ardhshëm të ESG-së ndikojnë në performancën financiare, reputacionin e bankës dhe marrëdhëniet e saj me palët e treta, përfshi investitorë, klientë, dhe organet rregullatorë.

Rreziqet që burojnë nga ndryshimet klimatike dhe mjedisin po marrin një rëndësi gjithnjë e më të madhe. Duke qenë kanalizues i flukseve të kapitalit, sistemi bankar ka një rol kyç në tranzicionin drejt një ekonomie më të qëndrueshme. Në këtë kuadër, si ndikimet klimatike, ashtu edhe tranzicioni drejt aktiviteteve të qëndrueshme përbëjnë burim rreziku për Bankën..

Është e rëndësishme të theksohet se kjo fazë zhvillimi nuk është specifike vetëm për bankën tonë, por reflekton një realitet më të gjerë të gjithë sistemit bankar, i cili ndodhet aktualisht në hapat e parë të ndërtimit dhe konsolidimit të kuadrit për menaxhimin e rreziqeve ESG. Banka fillimisht, është fokusuar tek identifikimi i rreziqeve materiale dhe mbi këtë bazë kryhet vlerësimi i ndikimit potencial në modelin e biznesit. Më tej, parashikohet përshtatja e strukturave të brendshme për të menaxhuar dhe mitiguar këto rreziqe, duke integruar dimensionin ESG në të gjitha kategoritë e rrezikut të bankës: kreditor, tregtar, operacional etj. Banka ka ndërmarrë hapa konkretë në drejtim të përfshirjes së rrezikut ESG në procesin e kreditimit, duke synuar zgjerimin gradual të këtij procesi edhe në kategoritë e tjera të rrezikut, duke zgjeruar Kuadrin e Oreksit të Rrezikut (RAF), sipas një plani veprimi 1–3 vjeçar. Ky plan është bazuar në Udhëzuesin mbi Rreziqet Financiare të Lidhura me Klimën dhe Mjedisin, të miratuar nga autoriteti mbikëqyrës.

## **12. Politika e Shpërblimit**

Komiteti i Shpërblimit dhe Burimeve Njerëzore është organi më i rëndësishëm dhe vendimmarrës në përcaktimin e incentivave dhe planit të kompensimit si pjesë e politikave të Burimeve Njerëzore.

Banka e konsideron këtë aspekt shumë të rëndësishëm pasi ka një ndikim domethënës në angazhimin, motivimin dhe sjelljen e punonjësve.

Struktura e Burimeve Njerëzore dhe Kulturës Organizative është nën vartësinë direkte të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të Bankës, i cili ka përgjegjësinë finale për çështjet e burimeve njerëzore në Bankë. Çështjet e burimeve njerëzore do të adresohen edhe nëpërmjet Komitetit të brendshëm të BNJ në Bankë.

### **12.1. Pagat**

Politika e Shpërblimeve zbatohet për të gjithë personelin e Bankës dhe mbulon të gjitha format dhe elementet e shpërblimit, shpërblimet e pandryshueshme, duke përfshirë pagën, dhe shpërblimet e ndryshueshme si bonuset, përfitime të tjera financiare dhe materiale dhe përfitimet nga pjesëmarrje në skemat e pensioneve vullnetare.

Struktura e Pagave në Union Bank është e bazuar në Sistemin e Gradave. Kjo strukturë është një mjet i standardizuar që vendimmarrësit në Bankë e përdorin për të mbajtur të balancuar nivelet e pagave brenda bankës dhe me tregun e punës. Struktura e Pagave përcakton kufijtë minimalë dhe maksimalë të pagës për

rolet që janë të klasifikuara në çdo gradë, dhe mundëson krahasimet me referencat e pagave në tregun e punës me fokus industrinë bankare.

Banka synon që sistemi i pagave të jetë i balancuar me nivelet e medianës së tregut për të mundësuar një nivel të lartë motivimi dhe kënaqësie në punë të stafit, një kulturë vlerësimi mbi bazë meritokracie dhe promovimi për aftësi, si edhe për të ndihmuar tërheqjen e kandidatëve në tregun e punës të një kalibri të lartë profesional.

### **Faktorët e ndryshimit të pagave**

Në vendimmarrjen e saj për rishikimin e nivelit të pagave Banka merr në konsideratë faktorët e mëposhtëm:

- Ndryshimi i nivelit të pagave në treg dhe dinamika të tjera të tregut të punës apo ndryshimeve te kuadrit ligjor.
- Rritja e kompetencave dhe përgjegjësi të rolit brenda Bankës, e cila shoqërohet me një rivlerësim të gradës dhe rishikim të nivelit të pagës brenda kufijve të gradës së re.
- Ndryshime strategjike, transformime dhe automatizim të aktiviteteve, krijimi i roleve të reja, roleve kritike për vijueshmërinë e aktivitetit të bankës.

Performanca individuale e punonjësit është një kriter dytësor dhe plotësues për rritjen e pagave. Duke u orientuar nga zhvillimet në tregun e punës, Banka bën analizat e duhura dhe në bazë të konkluzioneve mund të vendosë të nisat procesi i rishikimit ose jo të pagës. Banka mund të vendosë të bëjë ndryshime page për pozicione apo individë në momente specifike kur e shoh të nevojshme dhe në funksion të mbarëvajtjes së aktiviteteve të saj.

## **12.2. Elementet e ndryshueshëm**

Në Union Bank elementet e ndryshueshëm të shpërblimit janë shpërblimi për performancë, skemat nxitëse shpërblimi, shpërblimi për realizimin e projekteve dhe elemente të tjerë financiare që mund të paguhet të shtyrë në kohë (deferred).

Kjo kategori përfshin edhe përfitime për stafin të llojit, pjesëmarrje në skema sigurimi jete dhe shëndeti dhe në fondin e pensionit, çmime preferenciale për produkte dhe shërbime të bankës, mbulim të shpenzimeve të telefonave celularë dhe limitet përkatëse, fleksibilitet në orarin normal të punës, puna në distancë (remote).

Elementet e ndryshueshëm përcaktohen nga Banka në varësi të situatës financiare, performancës së përgjithshme të bankës dhe performancës së njësive të biznesit.

- Shpërblimi për performancë: aplikohet për të shpërblyer arritjet kundrejt objektivave të vendosura si objektiva sasiore dhe cilësore. Skema e shpërblimit për performancë është kryesisht e aplikueshme për rolet që ushtrojnë aktivitetin e tyre në struktura që nuk janë drejtpërdrejt me klientët. Komponentët e skemës së shpërblimit për performancë janë arritjet në performancën individuale dhe arritjet e përgjithshme të Bankës. Kjo skemë, mundëson dhe inkurajon rritjen e performancës dhe siguron transparencë dhe meritokraci. Detaje të komponentëve të kësaj skeme rishikohen dhe komunikohen çdo vit tek punonjësit.
- Shpërblimi për nxitje: Skema nxitëse për shitjet aplikohet dhe përshtatet për role të ndryshme që mbulojnë aktivitete me klientët në rajonet dhe degët e Bankës. Skemat nxitëse aplikohen edhe për struktura/role në Drejtorinë e Përgjithshme të cilat kanë objektiva sasiore. Skemat nxitëse mund të jenë edhe ad hoc, për shpërblim të punonjësve më të suksesshëm në nivel individual.
- Shpërblim për realizim projektësh: aplikohet për të nxitur realizimin me sukses dhe kontributin në projekte strategjike dhe me impakt shumë të lartë në aktivitetin dhe performancën e Bankës.

Këto elemente të ndryshueshëm të shpërblimit mund të jepen në mënyrë të pavarur ose të kombinohen sipas situatave, aktiviteteve dhe strukturës së objektivave të një njësie të caktuar.

## 12.3 Përfitimet për stafin e Bankës

Përfitimet për stafin e Bankës synojnë të jenë në linjë me tendencat e tregut të punës. Ato plotësojnë paketën e të gjitha shpërblimeve për ta bërë atë sa më tërheqëse për stafin e brendshëm dhe për kandidatët që i bashkohen Bankës.

Këto përfitime ndikojnë në mirëqenien e stafit dhe në ruajtjen e nivelit të lartë të motivimit dhe produktivitetit dhe uljen e rrezikut të largimeve nga puna. Skemat e këtyre përfitimeve janë:

- Sigurim i jetës dhe shëndetësor
- Fondi Vullnetar i Pensionit
- Çmime preferenciale për produktet bankare
- Pushim në ditën e ditëlindjes
- Orar i shkurtuar ditën e premte
- Përfitime të tjera të lidhura me pozicionin e punës

## 12.4 Vlerësimi i Performancës

*Vlerësimet e performancës* bëhen me qëllim për të vlerësuar performancën e punonjësve dhe për të siguruar një mundësi që punonjësi dhe eprori të diskutojnë përgjegjësitë e punës dhe të vendosin objektivat për të ardhmen.

Punonjësit do të vlerësohen në përfundim të tre muajve të parë të punësimit. Më pas, do të ketë minimalisht një vlerësim vjetor të stafit.

Edhe struktura e Këshillit Drejtues bën një vlerësim vjetor të anëtarëve të saj, e shprehur qartësisht në statutin e Këshillit Drejtues si dhe Drejtoria Ekzekutive së bashku me Drejtuesit e Divizioneve, procesin e vlerësimit të të cilëve e kryen Komiteti i Shpërblimit dhe Burimeve Njerëzore.

## 13. Politikat kontabël të Bankës

### a) Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare individuale janë përgatitur në përputhje me “Metodologjinë e raportimit dhe përmbajtjen e raporteve financiare” (“Metodologjia e Raportimit Financiar” ose “MRF”) miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë më 24 dhjetor 2008. Ato janë paraqitur në Lekë, e cila është edhe monedha funksionale, të rrumbullakosura në mijëshen më të afërt dhe janë përgatitur sipas parimit të koston historike.

Politikat kontabël të aplikuara nga Banka, janë në përputhje me ato të përdorura për përgatitjen e pasqyrave financiare korresponduese për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2025.

### b) Veprimet në monedha të huaja

Veprimet në monedha të huaja janë këmbyer me kursin e këmbimit të ditës së kryerjes së transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare të shprehura në monedhë të huaj, të cilat janë regjistruar me koston historike në datën e transaksionit, janë këmbyer me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Aktivitetet dhe detyrimet jomonetare në monedhë të huaj, të cilat mbahen me koston historike, janë këmbyer me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së veprimit. Diferencat që rrjedhin nga ndryshimi i kursit të këmbimit që rezultojnë nga konvertimi i aktiveve dhe detyrimeve monetare janë njohur në pasqyrën individuale të të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kapitali aksionar i kontribuar në monedhë të huaj trajtohet si një zë monetar dhe si i tillë konvertohet në Lekë duke përdorur kursin e këmbimit në datën e raportimit. Vetëm për qëllime prezantimi kapitali aksionar paraqitet në bilanc me vlerën në Lekë duke përdorur kursin historik, ndërsa diferenca mes kësaj vlere dhe vlerës në Lekë duke përdorur kursin e këmbimit në datën e raportimit, paraqitet veçmas si “rezervë e rivlerësimit”.

---

<sup>3</sup> Këto janë politikat kontabël sipas Bankës së Shqipërisë; politikat kontabël sipas Standarteve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNFR), janë të publikuara një herë në vit së bashku me pasqyrat financiare të audituara në site të Bankës në seksionin 3. Politikat Kryesore Kontabël.

**c) Arka dhe llogari me Bankën Qendrore**

Arka dhe llogari me Bankën Qendrore përbëhen nga gjendjet e parasë në arkë, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat me Bankën Qendrore, si dhe rezervën e detyrueshme me Bankën Qendrore.

**d) Depozitat dhe llogaritë me bankat**

Depozitat dhe llogaritë me bankat përfshijnë llogaritë rrjedhëse dhe depozitat ndërbankare me datë shlyerje dhe normë interesi të paracaktuar.

**e) Letra me vlerë të tregtueshme**

Letrat me vlerë të tregtueshme janë investime në obligacione të cilat janë përfituar që në fillim me synim për t'u rishitur në një periudhë afatshkurtër, deri në 6 muaj dhe kur: a) ato janë të negociueshme në një treg dhe b) çmimet e tregut të letrave me vlerë në fjalë janë gjithë kohës të disponueshme për të tretët. Ato janë regjistruar me çmimin e përfitimit të tyre, përfshi shpenzimet dhe çdo interes të përlllogaritur.

Në çdo datë kontabël të hartimit të pasqyrave financiare, ato vlerësohen me çmimin më të fundit të tregut. Shuma e përgjithshme e diferencave që rezulton nga ndryshimet e çmimit regjistrohet në llogarinë e fitimeve dhe humbjeve.

Banka rishikon periodisht klasifikimin e letrave me vlerë të tregtueshme përfshi datën e hartimit të pasqyrave financiare. Në vijim të këtij rishikimi nëse ka ndryshime në klasifikim ose pasi ato janë mbajtur të paktën për 6 muaj, letrat me vlerë të poseduara duhet të zhvendosen nga letrat me vlerë të tregtueshme në letra me vlerë të vendosjes ose letra me vlerë të investimit.

**f) Letra me vlerë të vendosjes**

Letrat me vlerë të vendosjes janë investime në obligacione të cilat mbahen për një periudhë prej më shumë se 6 muaj, me përjashtim të atyre letrave me vlerë të cilat banka synon t'i posedojë deri në datën e maturimit dhe të cilat kënaqin rregullat që kanë të bëjnë me letrat me vlerë të investimit. Letrat me vlerë të vendosjes regjistrohen në datën e përfitimit me çmimin e tyre të përfitimit përjashtuar shpenzimet.

Në çdo datë kontabël të hartimit të pasqyrave, do të krijohen fonde rezervë, sipas grupeve homogjene të letrave me vlerë të njëjtë lloj, kundrejt humbjeve kapitale të pa realizuara që rezultojnë nga diferenca midis vlerës kontabël dhe çmimit të tregut për letrat me vlerë. Fitimet kapitale të pa realizuara nuk regjistrohen.

**g) Investime në letra me vlerë mbajtur deri në maturim**

Investimet në letra me vlerë mbajtur deri në maturim konsistojnë në bono thesari dhe obligacione të Qeverisë Shqiptare, obligacione të qeverive të huaja dhe obligacione të korporatave të huaja të blera me qëllimin e mbajtjes së tyre deri në maturim dhe për rrjedhojë klasifikohen si të tilla.

Investimet në letra me vlerë të mbajtura deri në maturim regjistrohen në ditën e blerjes dhe fillimisht maten me kosto, përjashtoi shpenzimet. Nëse ato ishin regjistruar më parë si letra me vlerë të tregtueshme ose të vendosjes, atëherë ato do të regjistrohen me çmimin e tregut që mbizotëron ditën e transferimit.

Diferencat midis çmimit të përfitimit (kostos) apo çmimit të tregut në ditën e transferimit dhe vlerës nominale amortizohen gjatë periudhës.

Në datat raportuese letra me vlerë mbajtur deri në maturim maten me kosto të amortizuar, duke i zbritur fondin rezervë për mbulimin e humbjeve që krijohet për të mbuluar rrezikun e mospërmbushjes së detyrimit nga ana e emetuesit të letrave me vlerë.

**h) Huatë dhe paradhëniet për klientët dhe institucionet financiare**

Huatë dhe paradhëniet për klientët si edhe ato për institucionet financiare raportohen me vlerën e tyre neto të realizueshme me provigjionin e humbjeve specifike nga huatë. Huatë regjistrohen kur shuma totale është disbursuar dhe pagesat njihen kur paraja arkëtohet. Në rastin e Overdraftëve dhe paradhënieve të tjera, kur fondet nuk përdoren menjëherë, angazhimi i kredisë pasqyrohet jashtë bilancit.

Kreditë janë klasifikuar në një nga pesë kategoritë e rrezikut: standarde, në ndjekje, nënstandarde, të dyshimta, të humbura. Interesat kontabilizohen pjesë-pjesë sipas fluksit në kohë. Interesat e llogaritur por që nuk u ka ardhur afati i pagimit ose që nuk janë paguar ende, kalohen në llogarinë e të ardhurave dhe

njihen si aktiv në llogarinë “interesa të përllogaritur”. Kur huatë klasifikohen si nënstandarde, të dyshimta ose të humbura, nuk llogaritet më interes. Huatë mund të jenë objekt i një ristrukturimi.

Fondet rezervë për mbulim humbjesh janë krijuar në përputhje me rregulloren e Bankës së Shqipërisë “Mbi Administrimin e Rrezikut të Kredisë” (Rregullorja e Kredisë), miratuar me vendimin Nr.62 më 14.09. 2011, ndryshuar me vendimin nr.27, datë 27.03.2013, ndryshuar me vendim nr. 22, datë 27.02.2014, ndryshuar me vendim nr. 26, datë 01.04.2015, ndryshuar me vendim nr. 50, datë 30.03.2016, ndryshuar me vendimin nr. 52, datë 03.07.2019, ndryshuar me vendimin qarkullues nr.13, datë 12.03.2020 dhe ndryshuar me vendimin qarkullues nr.33 datë 28.05.2020 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Rregullorja kërkon që Banka të klasifikojë ekspozimet në kategori rreziqesh të mëposhtme.

Për çdo kategori të rrezikut, aplikohen normat minimale të provigjionimit për fondeve rezervë si më poshtë:

<b>Lloji i huasë</b>	<b>Norma e Fondit</b>
Standarde	1%
Në ndjekje	5%
Nën standard	Jo më pak se 20%
Të dyshimta	Jo më pak se 50%
Të humbura	100%

Për interesat e përllogaritur të huave nënstandarde, të dyshimta dhe të humbura, krijohet fond rezervë në masën 100%.

Fondet rezervë kontabilizohen si zhvlerësim i mjeteve (në bilanc) kundrejt llogarisë së humbjes në pasqyrën e fitimeve dhe të humbjeve. Në rastet e shlyerjeve të kredisë apo fshirjeve nga bilanci të gjitha fondet rezervë të regjistruara për këto shuma stornohen.

Huatë për klientët raportohen neto, pas zbritjes së fondeve rezervë për huatë që klasifikohen si nënstandarde, të dyshimta dhe të humbura. Fondet e krijuara për humbjet e mundshme nga huatë që klasifikohen si standarde dhe në ndjekje, regjistrohen si provigjion statistikor në anën e detyrimeve të bilancit kontabël nën kategorinë “Detyrime të tjera”.

Ndërsa huat për institucionet financiare raportohen neto, pas zbritjes së fondeve rezervë për huatë që klasifikohen si në ndjekje, nënstandarde, të dyshimta dhe të humbura. Fondet e krijuara për humbjet e mundshme nga huatë që klasifikohen si standarde, regjistrohen si provigjion statistikor në “Detyrime të tjera”.

#### **i) Investime në Filiale**

Investime në Filiale paraqet investimin në Landeslease sha dhe AFI të matur fillimisht me kosto. Në çdo datë raportuese të mëpasshme, përcaktohet vlera reale e aksioneve, dhe nëse parashikohet që vlera reale do të mbetet më e ulët se sa vlera kontabël neto për një periudhë afatgjate regjistrohet fondi rezervë për amortizim.

Dividentët kontabilizohen si e ardhur dhe regjistrohen në datën që ato shpallen zyrtarisht nga organizmat ligjorë të Filialit (Mbledhja e aksionarëve).

#### **j) Aktive të qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara**

Aktivitet e qëndrueshme të trupëzuara paraqiten dhe maten duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga rënia në vlerë, në qoftë se ka. Kosto përfishin shpenzime të cilat i atribuohen direkt blerjes së aktivitet. Programet kompjuterike që janë pjesë e funksionimit të pajisjes në të cilën ato janë instaluar, kapitalizohen si pjesë e asaj pajisjeje. Amortizimi llogaritet sipas metodës lineare mbi jetën e parashikuar të përdorimit të aktiveve. Aktivitet e qëndrueshme në proces nuk amortizohen.

Të ardhurat apo humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit të një aktivi të trupëzuar (llogaritur si diferencë midis arkëtimeve nga nxjerrja jashtë përdorimit dhe vlerës kontabël të aktivitet) njihen si të ardhura të tjera në pasqyrën e fitim humbjeve.

Aktivitet e patrupëzuara të blera nga Banka maten me kosto duke i zbritur amortizimin e akumuluar, i cili llogaritet sipas metodës lineare, dhe zhvlerësimin kur është i aplikueshëm. Amortizimi njihet në fitim humbje sipas metodës lineare, duke u nisur nga data në të cilën është i vlefshëm për punë.

Amortizimi dhe zhvlerësimi i vitit është llogaritur në përputhje me normat e mëposhtme:

Pajisje kompjuterike	25%
Pajisje zyre	20%
Aktive të tjera të trupëzuara	20%
Aktive të patrupëzuara (programe kompjuterike, shpenzime të nisjes dhe të tjera)	20%

Shpenzimet e mëpasshme kapitalizohen vetëm nëse është e mundshme që përfitimet ekonomike që i atribuohen atyre do të rrjedhin te Banka në të ardhmen. Të gjitha kostot e tjera të riparimit dhe mirëmbajtjes regjistrohen në shpenzimet kur ndodhin.

#### k) Përmirësimet e aktiveve të marra me qira

Përmirësimet e aktiveve të marra me qira perfaqësojnë “shpenzime për t’u amortizuar në disa vite”, sepse përdorimi i tyre shtrihet në më shumë se një periudhë kontabël. Afati i përdorimit të këtyre përmirësimeve varion nga 3 në 15 vjet. Këto shpenzime shpërndahen përgjatë periudhës së qirasë.

#### l) Aktive të trupëzuara të marra nëpërmjet një procesi ligjor

Aktive të trupëzuara të marra nëpërmjet një procesi ligjor, janë pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme të përfituara kundrejt shlyerjes së kredive të dhëna nga Banka klientëve. Vlera kontabël e këtyre aktiveve pritet të rikuperohet nëpërmjet shitjes së tyre.

Në rastet kur këto aktive nuk mund të shiten brenda vitit të parë të përfitimit të tyre, Banka krijon fonde rezervë për mbulimin e humbjeve nga zhvlerësimi i tyre.

Fondet rezervë për mbulim humbjesh nga zhvlerësimi i këtyre aktiveve gjatë vitit 2024 janë krijuar në përputhje me rregulloren “Mbi Administrimin e Rrezikut të Kredisë” (Rregullorja e Kredisë), miratuar me vendimin Nr. 62 me 14.09. 2011, ndryshuar me vendimin nr.27, datë 27.03.2013, ndryshuar me vendim nr. 22, datë 27.02.2014, ndryshuar me vendim nr. 26, datë 01.04.2015, ndryshuar me vendim nr. 50, datë 30.03.2016, ndryshuar me vendimin nr. 52, datë 03.07.2019, ndryshuar me vendimin qarkullues nr.13, datë 12.03.2020, ndryshuar me vendimin qarkullues nr.33 date 28.05.2020 dhe me vendimin nr. 5, datë 13.01.2021 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Rregullorja në fjalë kërkon që Banka të krijojë fonde si më poshtë:

Viti i marrjes në pronësi	Norma e Fondit
Viti i parë	5%
Viti i dytë	15%
Viti i tretë	30%
Viti i katërt	45%
Viti i pestë	60%
Viti i gjashtë	80%
Viti i shtatë	100%

#### m) Marrëveshjet e riblerjes

Marrëveshjet e riblerjes janë marrëveshje në të cilat Banka shet një aktiv financiar (letër me vlerë) dhe njëherësh hyn në një marrëveshje për të riblerë këtë aktiv me një çmim fiks në një datë të ardhshme (repo). Ky transaksion nuk konsiderohet si një nxjerrje e aktivitet jashtë përdorimit dhe Banka ruan të gjitha përfitimet që lindin nga zotërimi i aktivitet financiar (letër me vlerë). Në përmbajtje kjo marrëveshje është një hua dhe për rrjedhojë kontabilizohet si një detyrim financiar, dhe aktivi vazhdon të njihet në pasqyrat financiare të veçanta të Bankës.

#### n) Depozitat dhe llogaritë rrjedhëse

Depozitat dhe llogaritë rrjedhëse janë burimet kryesore të Bankës për financim. Depozitat me afat perfaqësojnë shumat e depozituara nga klientët, dhe mbartin një datë shlyerjeje dhe një normë interesi të pranuar. Ato kontabilizohen në datën fillestare të tyre si detyrim. Në datën e maturimit depozitat shlyhen ose rinovohen për një periudhë tjetër të pranuar. Interesat kontabilizohen pjesë pjesë sipas fluksit në kohë dhe regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe njihen si detyrim deri në momentin e pagesës.

**o) Borxhi i varur**

Paraqet huamarrje të Bankës të cilat, në rast likuidimi janë të dorës së dytë kundrejt shlyerjes së kreditorëve të tjerë. Vlera e borxhit dhe interesi i përllogaritur regjistrohen si detyrime. Cdo shpenzim lidhur me emetimin e borxhit është regjistruar si shpenzim i periudhës.

**p) Provigjonet**

Provigjoni është njohur nëse si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, Banka ka një detyrim ligjor që mund të matet me besueshmëri, dhe është e mundur që një dalje e përfitimeve ekonomike do të kërkohet për të shlyer detyrimin.

**q) Përfitimet e punojësve**

Banka paguan kontribute të detyrueshme për sigurimet shoqërore për përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

Nga Janar 2022, Banka ofron mundësinë që punonjësit të mund të jenë pjesë e një plani pensioni vullnetar, në të cilin kontributi i Bankës në kuotën mujore do të jetë 50%. Kontributet e Bankës ndaj planit të pensionit të detyrueshëm dhe atij vullnetar njihen si shpenzim në pasqyrën e veçantë të të ardhurave dhe shpenzimeve kur ato ndodhin.

**r) Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat**

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat njihen sipas parimit të të drejtave të konstatuara. Regjistrimi i tyre bëhet në bazë rrjedhëse (duke u bazuar tek përllogaritja), pra paraqiten kur ato fitohen ose shkaktohen.

**s) Të ardhurat dhe shpenzimet nga komisionet**

Të ardhurat dhe shpenzimet nga komisionet rrjedhin nga shërbimet financiare të ofruara nga Banka si transferimi i fondeve, aktivitete huadhënëse, tarifat e marra për krijimin e huave dhe paradhënieve të klientëve, tarifat e mirëmbajtjes së llogarive, komisione të garancive bankare, etj. Të ardhurat dhe shpenzimet nga komisionet njihen kur shërbimet përkatëse janë kryer.

**t) Të ardhurat dhe shpenzimet për qira**

Të ardhurat e marra dhe shpenzimet e bëra për qiratë operationale njihen në pasqyrën e fitim humbjeve sipas metodës lineare përgjatë jetës së qirase. Zbritjet e bëra apo të marra nga qiraja njihen si pjesë përbërëse e totalit të të ardhurave e shpenzimeve për qira, përgjatë afatit të qirasë.

**u) Veprimet spot të këmbimit valutor**

Banka gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm hyn në këmbime valutore spot me data likuidimi 2 ditë pas datës së veprimit. Këto veprime regjistrohen si zëra jashtë bilancit në datën e transaksionit dhe regjistrohen në pasqyrat financiare në datën e likuidimit. Efekti i rivlerësimit i balancave të zërave jashtë bilancit njihet dhe regjistrohet në datën e veprimit.

**v) Përdorimi i vlerësimeve**

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me MRF kërkon që menaxhimi të bëjë vlerësime dhe parashikime që ndikojnë në shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, në informacionin shpjegues për aktivet dhe detyrimet e mundshme ekzistuese në datën e pasqyrave financiare dhe në shumat e raportuara të të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë vitit të raportimit. Kur bëhen vlerësimet e nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare, Banka mban gjithmonë pozicionin më konservator për të shmangur rrezikun që mjetet ose të ardhurat të vlerësohen më tepër dhe detyrimet ose shpenzimet më pak. Pasqyrimi kontabël i mjeteve dhe detyrimeve bëhet në përputhje me përmbajtjen dhe realitetin ekonomik të tyre dhe jo vetëm me paraqitjen ligjore të tyre. Rezultati aktual mund të ndryshojë nga këto vlerësime.

**w) Informacioni krahasues**

Informacioni krahasues është paraqitur vazhdimisht në përputhje me politikën e kontabilitetit të Bankës.